



Raporti Vjetor

2013

NLB  Prishtina

1. Të dhënat kyçe financiare

000 EUR	2012	2013	Plan	Index 2013 / 2012	Plan
Koeficientët					
ROE pas tatimit	11.1%	7.4%	10.6%	-	-
ROA pas tatimit	1.1%	0.7%	1.1%	-	-
Raporti të hyra/shpenzime (CIR)	62.1%	56.3%	59.7%	-	-
Pjesëmarrja në treg me gjithsej mjetet	16.0%	16.3%	15.0%	-	-
Rangimi	3	3	3	-	-
Indikatori i mjaftushmerisë së kapitalit (BQK)	13.5%	16.5%	15.9%	-	-
Kapitali Tier 1 sipas BQK	34,344	40,670	39,493	18%	3%
Treguesit e bilancit të gjendjes					
Shuma e bilancit	423,476	464,095	422,500	9.6%	9.8%
Kreditë e SJB (neto)	234,138	240,369	257,900	2.7%	-7%
Pjesëmarrja në treg me kreditë (SJB)	14.6%	14.9%	14.0%	-	-
Depozitat (SJB)	367,217	407,835	365,000	11.1%	12%
Pjesëmarrja në treg me depozita (SJB)	16.0%	16.6%	15.5%	-	-
Kapitali	42,974	45,913	47,600	7%	-4%
Treguesit e bilancit të suksesit					
Neto fitimi	4,523	3,286	4,800	-27%	-32%
Rezultati financiar para tatimit	5,066	3,699	5,330	-27%	-31%
Neto të ardhurat gjithsej (të ardhurat/të dalat operative)	17,862	17,797	18,750	0%	-5%
Neto të hyrat kamatore gjithsej	14,142	14,021	15,100	-1%	-7%
Neto të hyrat jokamatore gjithsej	3,404	3,470	3,480	2%	0%
Shpenzimet operative gjithsej	(11,088)	(10,016)	(11,200)	-10%	-11%
Shpenzimet e pagave	(5,202)	(5,086)	(5,160)	-2%	-1%
Shpenzimet tjera operative	(4,795)	(3,858)	(4,440)	-20%	-13%
Amortizimi	(1,091)	(1,072)	(1,600)	-2%	-33%
Kualiteti i portofolit dhe provizionet					
Bruto kreditë e NBS	255,255	265,527	278,213	4%	-5%
Portofoli kreditor	355,821	365,777	391,380	3%	-7%
Përmirësimi i vlerave dhe rezervacioneve në gjendjen e bilancit	(23,239)	(27,488)	(25,380)	18%	8%
Rritja e përmirësimeve të vlerave dhe provizioneve (bil. suksesit)	(1,708)	(4,082)	(2,220)	139%	84%
Mbulesa e bruto kredive të SJB me provizione	8.3%	9.5%	9.1%	-	-
Mbulesa e portfolios kreditor me provizione	6.5%	7.5%	7.4%	-	-
Raporti i KJP në gjithsej kreditë	5.5%	6.2%	6.8%	13%	-
Raporti i KJP të Sektorit jobankar	6.5%	7.4%	8.4%	-	-
Mbulesa e KJP me provizione (Raporti i mbulesës)	127.0%	126.5%	111.5%	-	-
Treguesit e likuiditetit strukturor					
Pjesëmarrja e burimeve të NBS në shumën e bilancit	86.7%	87.9%	86.4%	-	-
Koeficienti i neto kredive NBS/depozitave NBS (LTD)	63.8%	58.9%	70.7%	-	-
Burimet (Resurset)					
Numri i të punësuarve	529	525	530	-1%	-1%
Numri i filialeve	9	9	9	0%	0%
Numri i ekspoziturave	41	40	40	-5%	-3%

Përmbajtja

1. Të dhënat kyçe financiare, 2
2. Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës , 4
3. Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina, 5
4. Rezyme, 6
5. Ambienti Makroekonomik , 7
6. Strategjia , 11
 - 6.1. Misioni, Vlerat dhe Vizioni, 11
 - 6.2. Objektivat Strategjike , 12
7. Qeverisja Korporative , 13
 - 7.1. Qeverisja Korporative dhe Organet Menaxhuese, 13
 - 7.2. Auditimi i brendshëm , 16
8. Rishikimi Financiar , 17
 - 8.1. Komentimi i pasqyrës së pozicionit financiar , 17
 - 8.2. Komentimi i bilancit të suksesit , 21
9. Aktivitetet sipas segmenteve afariste , 24
 - 9.1. Afarizmi me personat juridik, 24
 - 9.2. Afarizmi me retail , 26
 - 9.3. Thesari dhe pagesat, 29
 - 9.4. Teknologjia informative , 31
10. Menaxhimi i Riskut , 32
 - 10.1. Risku kreditor, Risku i likuiditetit, Risku i normës së interesit, Risku operacional, 32
 - 10.2. Menaxhimi i riskut të adekuatshmërisë së kapitalit, 33
11. Përgjegjësia Korporative , 34
 - 11.1. Aktivitetet sociale , 34
 - 11.2. Aktivitetet në aspektin e ambientit , 35
12. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore , 36
13. Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit, 38
14. Adresat dhe kontaktet, 121

2. Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës



Të nderuar aksionarë, klientë dhe kolegë!

Viti 2013 ishte një vit i tranzicionit për gjithë industrinë financiare në Kosovë, pasi që qëllimi i Bankave ka qenë përmbushja e kërkesave të reja në kuptim të dispozitave të Ligjit për Bankat, Institucioneve Mikro Financiare, Institucioneve Financiare Jo-Bankare si dhe Rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës. Ndërkohë, mjedisi mikroekonomik në zhvillim e sipër mbeti një sfidë për gjithë komunitetin e biznesit duke përfshirë bankat. Megjithatë, si rezultat i ndryshimit të industrisë, Banka gjatë vitit 2013 ka ndërmarrë veprime të shpejta dhe vendimtare në mënyrë që të tejkalohen pengesat dhe të ndiqen hapat strategjik drejt arritjes së objektivave të Bankës.

Në mjedisin e tanishëm sfidues makroekonomik, Banka ka vazhduar të mbështesë klientët e saj, duke i ndihmuar ata të realizojnë qëllimet dhe ambiciet e tyre financiare. Si rezultat i kësaj, unë jam i lumtur t'ju informoj se viti 2013 ishte një vit i suksesshëm për NLB Prishtina, ku shumica e objektivave të rritjes janë arritur ose tejkaluar dhe Banka ka shënuar përmirësime në shumicën e treguesve kyç të përformancës. Në mënyrë thelbësore, Banka ka forcuar pozitën e saj të kapitalit, pavarësisht qasjes konservative të caktuar nga Rregullat e reja të Bankës Qendrore si dhe ka zvogëluar shpenzimet operative. Në përputhje me rrethanat, pjesëmarrja e Bankës në treg është rritur në aspektin e totalit të aseteve, depozitave, si dhe në neto kredi.

Banka ka vazhduar implementimin e modelit të saj të afarizmit që është i fokusuar në fushat ku Banka mund të krijoj vlera të shtuara për klientët dhe aksionarët e saj. Ne besojmë se për shkak të fuqisë ndërkombëtare financiare dhe rrjetit të grupit NLB, të kombinuar me qasjen vendore, klientët tonë përfitojnë përmes këmbimit të njohurive më të mira, qëndrueshmërisë dhe lidhjeve në mbarë botën. Si rezultat i kësaj, Banka jonë vazhdon të jetë banka e tretë më e madhe në tregun e Kosovës me totalin e aseteve dhe depozitave.

Në vitin 2013, totali i aseteve të Bankës është rritur për 9.6% duke arritur në 464 milion EUR, dhe tejkaluar kështu planin për 9.8%. Depozitat nga sektori jo-bankar janë rritur për 11.1% (40.6 mil) dhe kanë arritur shumën prej 408 milion EUR, duke treguar që klientët tanë kanë një besim të lartë në shërbimet që ne ofrojmë dhe stabilitetin e Bankës. Neto kreditë e sektorit jo-bankar në fund të vitit ishin 240 milionë EUR dhe në krahasim me fundin e vitit të kaluar janë rritur për 2.7%. Rritja ishte më e ulët se plani për arsye se Banka ka vazhduar të qëndroj e vëmendshme dhe e përkushtuar drejt rritjes stabile, duke përdorur një qasje të matur të kreditimit të klientëve, e cila po ashtu është reflektuar në kualitetin e mirëfillt të portofolios kreditore.

Në të gjitha segmentet e afarizmit, rritja ka qenë sistematike dhe e kontrolluar dhe si rezultat i strategjisë sonë të rritjes së kujdesshme, NLB Prishtina ka gjeneruar tregues pozitiv në aspektin e profitabilitetit duke realizuar një fitim pas tatimit në shumë prej 3.3 milionë EUR sipas standardeve ndërkombëtare (BQK: 4,5 milion EUR) e cila korrespondon me një kthim në ekuitet prej 7.4% dhe kthim në asete prej 0.7%. Në vitin 2013, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe menaxhimit të likuiditetit dhe shfrytëzimit efikas të fondeve.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në vitin 2013, ishte i lartë prej 16.5%, mbi minimumin e kërkuar nga Banka Qendrore e Kosovës prej 12%, duke reflektuar kështu mbulesë të qëndrueshme të adekuatshmërisë së kapitalit dhe menaxhim efikas të kapitalit. Me qëllim të kuptimit të nevojave të klientëve dhe ofrimit të mbështetjes për përmbushjen e objektivave të tyre, Banka ka plasuar edhe produkte dhe shërbime të reja, duke drejtuar kështu investimet e saja për përmbushjen e nevojave të klientëve të Bankës.

Në vitin 2013, Banka ka përruruar objektin e selisë qendrore, e cila paraqet angazhimin e vazhdueshëm të Bankës në ofrimin e shërbimeve të kualitetit të lartë për klientët.

Unë fuqimisht besoj se duke qenë ekonomikisht i suksesshëm dhe konkurrues, Banka krijon vlerë për të gjithë akterët e saj, përfshirë aksionarët, klientët, të punësuarit si dhe për gjithë shoqërinë. Ne, vazhdojmë të aplikojmë standarde të larta mjedisore dhe sociale ndaj afarizmit tonë për të mbështetur një të ardhme të qëndrueshme. Banka edhe në vitin 2013 ka vazhduar përfshirjen dhe mbështetjen aktive në fushën e sportit, artit, kulturës, si dhe aktiviteteve tjera sociale. Ne gjithashtu e kemi të qartë së detyra jonë ndaj akterëve tjerë është të jemi partner i besueshëm, me integritet, etikë dhe transparencë të lartë.

Në vitin 2014, duke pasur parasysh sfidat dhe paparashikueshmërinë e mjedisit ekonomik dhe financiar, rritja e pjesëmarrjes në treg dhe rritja në përgjithësi nuk do të jetë qëllimi ynë kryesor. Në këtë drejtim, Banka do të përqendrohet në kualitet e jo në kuantitet. Ne jemi të bindur se duke krijuar vlera të shtuara për klientët dhe aksionarët, ne do të kontribuojmë në qëndrueshmërinë afatgjatë të NLB Prishtina. Gjithashtu, ju siguroj se Banka jonë në vitin 2014 dhe vitet e ardhshme do të vazhdojë të perfeksionoj produktet dhe shërbimet për të mirën e klientëve të saj.

Së fundi, unë dëshiroj të shpreh falënderimet më të sinqerta për të gjithë të punësuarit e Bankës për angazhimin dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm, Bordin e Drejtorëve për mbështetjen dhe udhëzimet e tyre profesionale, aksionarët dhe klientët për besimin dhe mbështetjen e tyre.

Albert Lumezi,
Kryetar i Bordit Udhëheqës

3. Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina



4. Rezyme

NLB Prishtina është banka e tretë më e madhe në tregun e Kosovës, e cila është themeluar nga bashkimi i dy bankave NLB BRK dhe NLB Kasabank më 1 janar 2008. NLB Prishtina ofron shërbime bankare dhe shërbime financiare të kualitetit të lartë për klientët e saj në tregun bankar të Kosovës.

NLB Prishtina ushtron veprimtarinë e vet bankare në të gjitha qytetet e mëdha të Kosovës, me një rrjet prej 9 filialeve, 30 ekspoziturave dhe 10 sporteleve.

NLB Prishtina funksionon si një Bankë universale, e cila ofron një portofolio të gjerë të shërbimeve bankare për të përmbushur nevojat e klientëve fizik dhe juridik. Ekspertët bankar të NLB Prishtina dhe stafi profesional janë të përkushtuar për të përmirësuar pozitën e Bankës në treg, duke u kujdesur me përgjegjësi për nevojat e klientëve, aksionarëve, të punësuarve dhe komunitetin e gjerë.

NLB Prishtina më 31 dhjetor, 2013 kishte 525 të punësuar që janë në shërbim të më shumë se 240 mijë klientëve fizik dhe atyre juridik. Aksionar kryesor i NLB Prishtina është NLB d.d. që mban 81.21%, ndërsa pjesa tjetër prej 18.71% janë firma private dhe persona fizik. Totali i aseteve me 31 dhjetor 2013 ishte 464 milion EUR.

NLB Prishtina është anëtare e Grupit NLB - organizata më e madhe financiare në Slloveni e cila ofron shërbime bankare si dhe shërbime të tjera financiare, sigurime, menaxhim të aseteve, lizing, faktoring dhe konfiskime, dhe operon në 13 vende si: Slloveni, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Kroaci, Gjermani, Itali, Austri, Republikën Çeke dhe Zvicër.

5. Ambienti Makroekonomik

Aktiviteti ekonomik në vend gjatë vitit 2013 ka vazhduar të konsiderohet si i qëndrueshëm dhe ka mbetur në trendin e njëjtë sikurse në vitin e kaluar, me një përmirësim të vogël, veçanërisht në rritje të eksportit dhe ulje të importit.

Ekonomia e Kosovës ka vazhduar të zhvillohet dhe të shfaqë stabilitet në raport me rajonin. Zhvillimet për rritje vazhdojnë të jenë në përputhje me zhvillimet e pritshme në Gjermani dhe Zvicër, të cilat janë vendet kryesore të Diasporës së Kosovës. Remitencat dhe hyrjet e tjera nga diaspora vazhdojnë të mbeten gjeneratori kryesor i kërkesës së brendshme dhe rritjen ekonomike. Ekonomia vazhdon të karakterizohet nga një deficit i lartë tregtar dhe normë e lartë e papunësisë që paraqet sfidën kryesore për stabilitetin ekonomik dhe social në vend .


Bruto Produkti Vendor (BPV-GDP) - Rritja vjetore e BPV (GDP) për ekonominë e Kosovës mbetet modeste në 3.1% bazuar në vlerësimin preliminar të BQK, ndërsa bazuar në rritjen e FMN-së është vlerësuar në 2.6%, ndërsa perspektiva për vitin 2014 është parashikuar të vazhdojë me rritje të vogël . Parashikimi është rreth 3.9% në vitin 2014. Kontribuuesit kryesor në këtë rritje kanë mbetur shpenzimet publike dhe konsumi privat . Në terme nominale, BPV (GDP) ishte rreth 5.1 miliardë EUR në vitin 2013.

000 EUR	2011	2012	2013 (vlerësimi)	2014 (parashikimi)
BPV - nominale (në mil. EUR)	4,770	4,916	5,149	5,460
BPV - rritja (vjetore në %)	4.4%	2.5%	2.6%	3.9%
BPV për kapita, €	2,652	2,708	2,794	2,909
Eksportet (në mil. EUR)	319.2	276.1	293.9	-
Importet (në mil. EUR)	2,492.3	2,507.6	2,450.4	-
Remitencat nga Diaspora (në mil. EUR)	585	605	* 272	-
Investimet direkte të huaja (në mil. EUR)	414	229	* 143	-
Inflacioni (CPI) mesatarja e periudhës	7.3%	2.5%	1.9%	1.8%

Burimi: Raporti i fundit i IMF (Dhjetor, 2013); * të dhënat janë për gjashtë muaj të vitit 2013.

BPV për kokë banori i Kosovës vazhdon të jetë më i ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit tonë. BPV për kokë banori në Kosovë qëndron në rreth 2,750 EUR për vitin 2013, pak a shumë e njëjtë si në vitin e kaluar.

Ilustrimi 1: Rritja e BPV dhe CPI (mesatarja e periudhës) – inflacioni



Inflacioni - Bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK), inflacioni për vitin 2013 është parashikuar të jetë rreth 1.9 % në bazë të raporteve të FMN të lëshuara në Dhjetor 2013, ndërsa për vitin 2012 ishte 2.5%. Inflacioni i tillë është i shtyrë kryesisht nga paqëndrueshmëria e artikujve ushqimorë të importuara, të naftës, që kanë ndikuar në të hyrat reale dhe normat reale të interesit.

Investimet e huaja direkte dhe dërgesat e emigrantëve (remitencat) - paraqesin komponent të rëndësishëm të investimeve në Kosovë edhe gjatë vitit 2013. Investimet e huaja direkte gjatë vitit 2013 kanë shënuar rënie, ndërsa remitencat kanë mbetur në të njëjtin trend si në vitin paraprak.

Privatizimi i distribucionit të energjisë elektrike të KEK-ut ka përfunduar gjatë vitit 2013, ku është blerë nga kompania turke Çalik group; privatizimi i PTK-së e cila ishte planifikuar të bëhet në vitin 2013 është shtyrë për vitin 2014, si dhe autostrada me Maqedoninë e cila është shtyrë për vitin 2014.

Papunësia e cila është një nga problemet më të mëdha të Kosovës ende qëndron e lartë dhe është përqindja më e madhe në rajon.

Aktualisht negociatat në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë janë duke vazhduar me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve, bashkëpunimit ekonomik dhe qarkullimit normal të mallrave dhe shërbimeve. Negociatat janë të ndërmjetësuara nga përfaqësuesit e BE-së.

Pavarësia e Republikës së Kosovës është njohur nga mëse 105 vende gjithsej, duke përfshirë 23 vende të BE-së.

Kosova ka vazhduar procesin e saj të integritetit në Organizatën financiare ndërkombëtare, ku Kosova është bërë anëtare edhe e BERZH-it, dhe më herët është bërë anëtare e FMN-së dhe Bankës Botërore.

Pasqyra e Sistemit Bankar

Sektori bankar në Kosovë ka vlerën 2.8 miliardë EUR më 31 dhjetor 2013, që do të thotë rreth 55% të produktit të brendshëm bruto. Profitabiliteti i sektorit bankar për vitin 2013 ishte 26.5 milion EUR bazuar në standardet lokale.

Bankat vazhdojnë të jenë të kapitalizuara mirë, me gjithë rënien e treguesit të adekuatshmërisë së kapitalit (CAR) në 15%, që kryesisht i atribuohet përshtatjes me rregullat e reja të nxjerra nga Banka Qendrore, që është mbi kërkesat e përcaktuara nga BQK në 12%.

Sistemi bankar i Kosovës mbetet i qëndrueshëm sa i përket likuiditetit, ku raporti i kredive ndaj depozitave në fund të muajt dhjetor të vitit 2013, ishte rreth 70 %, me një pjesë të kënaqshme të aseteve likuide ndaj totalit të aseteve dhe një cilësi të mirë të portofolios kreditore. NLB Prishtina ka vazhduar të ketë një fuqi solide financiare dhe monitoron rregullisht ndryshimet në sistemin bankar dhe konkurrencën.


Sektori bankar më 31 dhjetor 2013, është përfaqësuar nga nëntë (9) banka (2012 : 8 banka), dhe prej afërsisht 3,510 të punësuar.

Sistemi bankar në vitin 2013 ka vazhduar të ketë një rritje modeste në zërat kryesorë bilancor. Struktura e aseteve ka vazhduar të financohet kryesisht nga depozitat dhe është përqendruar në aktivitetin kreditues, si dhe investimin në bono të thesarit të Republikës së Kosovës.

Tabela 1: Pasqyra e rrjetit afarist të bankave në Kosovë (BQK)

000 EUR	Asetet		Kreditë e SJB		Depozitat e SJB		Neto fitimi	
	2012	2013	2012	2013	2012	2013	2012	2013
NLB Prishtina	423,902	465,715	233,059	240,625	362,612	403,510	4,506	4,538
<i>Bankat tjera</i>	2,217,321	2,387,707	1,357,854	1,369,306	1,906,726	2,033,685	14,143	21,998
Totali i sektorit bankar	2,641,223	2,853,422	1,590,913	1,609,931	2,269,338	2,437,195	18,649	26,536

Ilustrimi 2: Rritja në zërat kryesorë : NLB Prishtina vs Sektori Bankar 2013




*Shënim: Të dhënat për vitin 2013, janë në bazë të të dhënave preliminare.

NLB Prishtina në 2013 ka vazhduar të jetë banka e tretë më e madhe në tregun e Kosovës me totalin e aseteve, dhe me pjesëmarrje në treg me 16.3% (2012: 16.0%), një rritje për 0.3%. Rritja e totalit të aseteve për vitin aktual ka qenë 9.9%, ndërsa rritja e përgjithshme e sistemit bankar ishte 7.9%.


Sa i përket neto kredive të sistemit jo-bankar (NBS), NLB Prishtina për vitin 2013 bazuar në standardet lokale ka pasur pjesëmarrje në treg prej 14.9% (2012: 14.6%), një rritje për 0.3% në pjesëmarrje në treg. Rritja e neto kredive në vitin 2013 krahasuar me 2012 ishte 3.2%, rritja ishte më e lartë sesa rritja e tërë sistemit bankar prej vetëm 1.2%.

Ilustrimi 3: Pjesëmarrja në treg e NLB Prishtina në 2013 në krahasim me sektorin bankar sipas zërave kryesor


Pjesëmarrja në treg, pasuritë 31.12.2013




Pjesëmarrja në treg, kreditë 31.12.2013



Pjesëmarrja në treg, depozitat 31.12.2013



Pjesëmarrja në treg, fitimi neto 31.12.2013



Tek depozitat e sektorit jo-bankar, NLB Prishtina në 2013 kishte pjesëmarrje në treg me 16.6% (2012: 16.0%), dhe ka rritur pjesëmarrjen në treg me 0.6%. Rritja e depozitave në 2013 krahasuar me vitin paraprak ishte 11.3%, krahasuar me rritjen totale të sistemit bankar 7.3%,

Sa i përket neto fitimit, NLB Prishtina në vitin 2013, sipas standardeve lokale kishte një pjesëmarrje në treg me 17.1% (2012: 24.1%), ose banka e dytë më e madhe në vitin 2013 me neto fitim.

6. Strategjia

6.1. Misioni, Vlerat dhe Vizioni

Banka është e përkushtuar për zhvillimin e një kulture duke u fokusuar në klientin, ndërgjegjësimin e riskut, integritetin, organizimin, proceset mbështetëse dhe përgjegjësinë sociale.

Besimi i klientëve, të punësuarve, aksionareve dhe shoqërisë në të cilën operon, e vendosë Bankën para një përgjegjësie të madhe. Banka e nderon këtë besim duke punuar së bashku me palët e interesuara për ndryshime pozitive, përfitimit të ndërsjellë dhe rritje ekonomike. Me përfshirjen e vlerave të saj në çdo aktivitet, Banka kontribuon në ndryshime pozitive në mjedisin e saj.

NLB Prishtina funksionon si një bankë kohesive, duke kombinuar ekspertizën ndërkombëtare nga Grupi NLB me njohuritë vendore. Një qasje e tillë fleksibile mundëson ofrimin e shërbimeve cilësore dhe zgjidhjeve afariste për klientët e Bankës. NLB Prishtina është Bankë e fokusuar ndaj klientit, që synon nëpërmjet proceseve efikase të ofrojë rritje të vlerës për klientët dhe aksionerët e Bankës. NLB Prishtina ka për qëllim të jetë partner i besueshëm dhe afatgjatë me klientët

Me përgjegjësi të madhe, dhe nëpërmjet kontributit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, NLB Prishtina punon drejt ndërtimit të një partneriteti afatgjatë me klientët, aksionarët dhe shoqërinë në të cilën operon. NLB Prishtina nderon besimin e klientëve duke punuar së bashku me qëllim të përfitimeve të ndërsjella, rritjes ekonomike si dhe duke kontribuar në ndryshime pozitive në mjedisin e gjerë.



6.2. Objektivat Strategjike

Objektivat strategjike të NLB Prishtina janë bazuar në supozimin se është një Bankë ndërkombëtare me qasje lokale, që zhvillon modelin e vet afarist në përputhje me objektivat e vendosura nga kompania amë NLB d.d. dhe siguron burimet e nevojshme strategjike për rritjen dhe zhvillimin. Implementimi i tyre, megjithatë, do të përshtatet kur është e nevojshme për të reflektuar kushtet aktuale.

NLB Prishtina ka për qëllim që të jetë një nga bankat me shërbimet më të mira dhe banka më e respektueshme në Kosovë. Ne e vlerësojmë përgjegjësinë tonë ndaj shoqërisë si punëdhënës, bankë dhe si një anëtare e shoqërisë Kosovare. Andaj ne jemi të zotuar që të kontribuojmë pozitivisht në ekonominë e Kosovës nëpërmjet aktiviteteve tona biznesore.

- Të mbaj pjesëmarrjen aktuale të tregut dhe të vlerësohet nga publiku i gjerë si një nga bankat më të besueshme në treg;
- Fokusimi në nevojat e klientëve dhe shoqërisë të cilës i shërben, duke ofruar vlera të qëndrueshme afat-gjate për të gjithë;
- Menaxhimi efikas i riskut dhe kapitalit
- Të ruajë bazën e klientëve, të arrij/realizoj rritjen e vëllimit afarist si dhe rritjen e të hyrave;
- Përmirësimi i efikasitetit në të gjitha aspektet operative nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm të operacioneve bankare
- Të jetë një urë lidhëse në mes të ekonomisë Sllovene dhe Kosovës dhe vendet ku NLB Grup është prezent;
- Menaxhimi aktiv i portofolios kreditorë dhe menaxhimi aktiv i koeficientit të LTD-së

NLB Prishtina ofron shërbime të plota bankare për klientët e saj.

Shtyllat kryesore strategjike përfshijnë: Aktivitetet bankare me persona juridik, aktivitetet bankare me persona fizik si dhe Thesari dhe Pagesat.

Masat për të arritur objektivat strategjike

Banka ndjek zhvillimin në përputhje me strategjinë duke tentuar të jetë një nga bankat më të mira për klientët, duke përdorur një sërë masash të performancës. Përparimi në këto fusha është matur kundrejt një numri të treguesve kryesore financiar dhe jo-financiar të cilët janë të paraqitura në këtë raport.

Objektivat specifike përcaktohen për secilën periudhë dhe periudhën 5 vjeçare. Çdo dobësi kyçe eliminohet brenda një periudhe kohore nëpërmjet monitorimit të rregullt.

Sfidat kryesore për arritjen e objektivave strategjike mbeten:


- Mjedisi ekonomik: i dobët, këndvështrimi për ekonominë e Kosovës, së bashku me pasiguritë e vazhdueshme ekonomike në Eurozonë.
- Mjedisi Rregullator: Pasiguria mundet të ngritët për shkak të ndryshimeve të akteve bankare, në veçanti në kërkesat për kapital dhe likuiditet.
- Konkurrenca: Rritja e konkurrencës në treg për kreditim dhe depozita krijon presion të marzhave kamatore.
- Sistemi ligjor: funksionimi jo i duhur i mjedisit ligjor, me procese jo adekuate kundrejt zbatimit të marrëdhëjeve kontraktuale.

7. Qeverisja Korporative

7.1. Qeverisja Korporative dhe Organet Menaxhuese

NLB Prishtina ka një strukturë të qartë organizative që saktësisht përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe organeve të tjera të menaxhimit, të punësuarit e tjerë, si dhe të linjave të kontrollit dhe të kontrolleve në kryerjen e detyrave të përditshme.

Struktura organizative e NLB Prishtina është si më poshtë:



Banka menaxhohet nga Bordi Udhëheqës dhe mbikëqyret nga Bordi i Drejtorëve

Organet kryesore të Bankës janë:

- Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve,
- Bordi i Drejtorëve
- Komiteti i Auditimit
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut
- Bordi Udhëheqës i Bankës
- Organet tjera operative

Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve e NLB Prishtina organizohet dhe merr vendime në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, ku miraton vendimet në përputhje me ligjin.

Përgjegjësitë e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të NLB Prishtina janë të përcaktuara me Statutin e NLB Prishtina, të cilat janë gjithashtu në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga rregullatori.

Gjatë vitit 2013, është mbajtur një Mbledhje e Përgjithshme e Aksionarëve. Mbledhja është mbajtur më 28 mars 2013, që ishte edhe mbledhja e rregullt e përgjithshme të aksionarëve për vitin 2013. Në mbledhje ishin të pranishëm 90.7% të aksionarëve. Ndër detyrat e tjera të rregullta, në këtë takim të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve u miratuan: Raporti i Auditorit të jashtëm për vitin 2012, Plan i Afarist për periudhën 2013-2017, ndryshimet në strukturën e Bordit të Drejtorëve, caktimi i auditorit të jashtëm për vitin 2013 dhe ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të NLB Prishtina sh.a..

Kapitali aksionar

Kapitali i autorizuar aksionar i Bankës më 31.12.2013 përbëhej nga 42,739 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 479,61 EUR për aksion. Aksionet nominale i përcaktojnë pronarëve të drejtën mbi pagesën e dividendës dhe të drejtën e votës në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve. Kapitali i autorizuar aksionar i Bankës përfaqëson të gjithë kapitalin aksionar të paguar. Gjithsej kapitali i regjistruar ishte 20,498 mijë EUR, ndërsa gjithsej kapitali aksionar më 31 Dhjetor, 2013 ishte 45,913 mijë EUR (2012: ishte 42,974 mijë EUR).

Aksionari më i madh i NLB Prishtina është NLB d.d. me 81.21%, ndërsa të dhënat më të detajuara janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare të audituara në kuadër të këtij raporti.

Bordi i Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve zgjidhet nga aksionarët Bankës, në Mbledhjen e Përgjithshme vjetore të Aksionarëve dhe është përgjegjës pos tjerash edhe për krijimin e politikave, duke përfshirë politikën për menaxhimin e riskut dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Bordi i Drejtorëve kryen detyrat në përputhje me dispozitat e ligjeve mbi qeverisjen bankare dhe Statutin e Bankës të NLB Prishtina sh.a.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2013 ka mbajtur 6 mbledhje.

Më datë 31 dhjetor 2013, struktura e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NLB Prishtina sh.a. ishte si në vijim:

1. Janko Medja, kryetar
2. Jure Peljhan, nënkryetar
3. Andrej Baricic, anëtar
4. Aleksander Vozel, anëtar
5. Ardiana Bunjaku, anëtare
6. Albert Lumezi, anëtar – Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB Prishtina sipas funksionit pa të drejtë vote.

Bordi i Drejtorëve i NLB Prishtina ka themeluar Komitetin e Auditimit ashtu siç është kërkuar nga ligji mbi bankat. Anëtarët e Komitetit të Auditimit me datë 31 dhjetor 2013, ishin:

1. Andrej Baricic , Kryetar i Komitetit të Auditimit
2. Ardiana Bunjaku, anëtare e Komitetit të Auditimit

Më datë 31 dhjetor 2013, anëtarët e Komitetit të Riskut ishin:

1. Aleksander Vozel, Kryetar
2. Jure Peljhan, anëtar
3. Ardiana Bunjaku, anëtar

Bordi Udhëheqës i Bankës

Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina udhëheq, përfaqëson dhe vepron në emër të Bankës, në mënyrë të pavarur dhe me vetë-përgjegjësi, ashtu siç parashihet me Statutin e Bankës. Kryetari dhe anëtarët emërohen me një mandat prej katër vitesh, dhe mund të riemërohen ose të tërhiqen para skadimit të mandatit në përputhje me Ligjin dhe Statutin e Bankës. Bordi Udhëheqës i NLB Prishtina përbëhet nga tre persona: z. Albert Lumezi, Kryetar i Bordit Udhëheqës, z. Bogdan Podlesnik, anëtar i Bordit Udhëheqës dhe z. Lavdim Koshutova, anëtar i Bordit Udhëheqës.

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të duhur të afarizmit të Bankës si dhe monitorimin e aktiviteteve të rregullta, brenda Bankës gjithashtu veprojnë këto këshille/komitete:

- Komitetit për menaxhimin e Aktives dhe Pasives (ALCO)
- Komiteti kreditor
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Kreditor
- Komiteti i Sigurisë
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Operacional
- Komiteti i IT-së
- Komiteti i Personelit
- Komiteti i Prokurimit
- Komiteti i marketingut

Në kuadër të Komitetit të ALCO-s është themeluar edhe nën komitetit i quajtur Komiteti i Çmimeve.

7.2. Auditimi i brendshëm

Spektori i Auditimit të Brendshëm i NLB Prishtina është Spektori i pavarur , i cili funksionon në një rol këshillues të pavarur dhe objektiv, duke përdorur një qasje sistematike dhe profesionale për të vlerësuar menaxhimin e riskut, sistemin e kontrollit të brendshëm dhe efikasitetin e operacioneve të Bankës. Auditimi i brendshëm jep një kontribut të rëndësishëm për Bankën për të përmbushur objektivat e saj strategjike dhe afariste dhe për të aplikuar praktikatat më të mira bankare .

Metodologjia e punës së Auditimit të Brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në Statutin e Auditimit , ndërsa udhëzimet dhe procedurat e punës janë të përshkruara në Manualin e Auditimit të Brendshëm . Të dyja këto dokumente janë plotësisht në përputhje me standardet e Qendrës së Auditimit të Brendshëm në NLB d.d., praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me ligjin bankar në Kosovë. Auditimi i brendshëm i NLB Prishtina funksionon dhe është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe Auditorët e Brendshëm veprojnë në përputhje të plotë me Kodin e Etikës së auditimit të brendshëm.

Gjatë vitit 2013 puna e auditimit të brendshëm është kryer në përputhje me Planin e Auditimit të Brendshëm për 2013. Në bazë të planit të auditimit, janë kryer shtatëmbëdhjetë (17) auditime të rregullta që mbulojnë fushat kryesore të aktiviteteve të Bankës duke përfshirë riskun kreditor, afarizmin me kartela, funksionin e Teknologjisë Informative, Parandalimin e shpëlarjes së parave , kreditë e personave fizik dhe personave juridik, si dhe auditimet e paparalajmëruara në degë/ekspozitura. Një Auditim është kryer në bashkëpunim me stafin e Qendrës së Auditimit të Brendshëm të NLB dd në Lubjanë .

Përveç kësaj , Auditimi i brendshëm ka monitoruar rregullisht zbatimin e rekomandimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës , Auditori i Jashtëm , dhe sektori i Auditimit të Brendshëm . Statusi i rekomandimeve të hapura është raportuar në baza tremujore në Komitetin e Auditimit , Bordin e Drejtorëve , Bordin Udhëheqës dhe Qendrën e Auditimit të Brendshëm të NLB dd.

8. Rishikimi Financiar

8.1. Komentimi i pasqyrës së pozicionit financiar


Pavarësisht mjedisit sfidues ekonomik dhe rregullator NLB Prishtina ka vazhduar të ketë performancë të mirë financiare edhe në vitin 2013 ku ka realizuar fitim të qëndrueshëm dhe të hyra të kënaqshme. Likuiditeti i Bankës gjithashtu mbetet i qëndrueshëm.

Zërat kryesor nga Pasqyra e pozicionit financiar

000 EUR	Aktuale 31.12.2012	Aktuale 31.12.2013	Struktura	Ndryshimi		Plani 31.12.2013	Krahasimi me Planin	
Paratë e gatshme dhe gjendja me BQK	61,410	92,142	20%	30,732	50%	42,000	50,142	119%
Mjetet financiare në dispozicion për shitje	58,383	54,104	12%	(4,279)	-7%	45,000	9,104	20%
Kreditë e bankave	57,715	65,054	14%	7,339	13%	62,300	2,754	4%
Kreditë e sektorit jo-bankar (gjithsej)	234,138	240,369	52%	6,231	3%	257,900	(17,531)	-7%
<i>Kreditë e korporatave</i>	155,860	163,440	35%	7,580	5%	168,300	(4,860)	-3%
<i>Kreditë e retail</i>	78,278	76,929	17%	(1,349)	-2%	89,600	(12,671)	-14%
Mjetet e luajtshme dhe të paluajtshme	10,877	11,318	2%	441	4%	14,500	(3,182)	-22%
Mjetet e tjera	953	1,108	0%	155	16%	800	308	39%
Gjithsej Pasuritë	423,476	464,095	100%	40,619	10%	422,500	41,595	10%
Depozitat (gjithsej)	367,426	408,726	88%	41,300	11%	365,300	43,426	12%
Depozitat e bankave	209	891	0%	682	326%	300	591	197%
Depozitat e klientëve (SJB)	367,217	407,835	88%	40,618	11%	365,000	42,835	12%
<i>Depozitat e korporatave</i>	123,788	119,695	26%	(4,093)	-3%	118,500	1,195	1%
<i>Depozitat e retail</i>	243,429	288,140	62%	44,711	18%	246,500	41,640	17%
Huamarrjet	8,774	5,455	1%	(3,319)	-38%	5,500	(45)	-1%
Detyrimet e tjera	4,302	4,001	1%	(301)	-7%	4,100	(99)	-2%
Gjithsej Detyrimet	380,502	418,182	90%	37,680	10%	374,900	43,282	12%
Zërat e Ekuitetit, përveç fitimit të vitit	38,451	42,627	9%	4,176	11%	42,800	(173)	0%
Fitimi i vitit të tanishëm	4,523	3,286	1%	(1,237)	-27%	4,800	(1,514)	-32%
Gjithsej Ekuiteti	42,974	45,913	10%	2,939	7%	47,600	(1,687)	-4%
Gjithsej Detyrimet dhe Ekuiteti	423,476	464,095	100%	40,619	10%	422,500	41,595	10%

Shuma bilancore e NLB Prishtina më 31.12.2013 ka arritur në 464,095 mijë EUR dhe krahasuar me 31.12.2012 ka shënuar rritje për 40,6 milion EUR (ose 9.6%). Ndërsa, plani vjetor në gjithsej asetet është tejkaluar për 9.8%. Rritja ka qenë në të gjitha linjat kryesore të bilancit të gjendjes.

Ilustrimi 4: Bilanci i gjendjes i NLB Prishtina dhe struktura e aseteve




Paraja e gatshme dhe bilancet në bankën qendrore (BQK) janë rritur për 92,142 mijë EUR, një rritje prej 30,732 mijë EUR (ose 50%) në krahasim me vitin e kaluar të cilat kanë kontribuar në likuiditetin e Bankës. Paraja e gatshme dhe bilancet në bankën qendrore janë rritur kryesisht për shkak të kufizimeve për investime në asete më shumë profitabile. Paraja e gatshme dhe bilanci me bankën qendrore përfshin shumën prej 33.382 mijë EUR në para të gatshme të mbajtura në Bankën Qendrore si rezerva e detyrueshme të likuiditetit.

Kreditë në bankat tjera më 31 dhjetor 2013 kanë arritur në 65,055 mijë EUR. Krahasuar me vitin e kaluar kane shënuar rritje për 7,340 mijë EUR (ose 12.7%). Të gjitha plasmanët janë në vendet e OECD të cilët kanë klasifikime të larta kreditore. Megjithatë normat e interesit janë ulur gjatë vitit 2013, duke sjellë të ardhura më të ulta nga interesi. Në pasqyrat financiare të audituara në vitin 2013 Kreditë në bankat tjera janë për 5,020 mijë EUR më të vogla për shkak të prezantimit në mënyrë të ndryshme (kjo shumë është raportuar tek "Para të gatshme në banka").

Investimet në letrat me vlerë me datë 31 dhjetor 2013 ishin 54,104 mijë EUR, një rënie prej 4.2 milion EUR (ose 7.3%). Shuma 4,041 mijë EUR është investuar në bono të thesarit të qeverisë Sllovene, shuma 46,062 mijë EUR bono të thesarit të qeverisë së Kosovës, dhe shuma 4,001 mijë EUR në bono të thesarit të qeverisë së Belgjikës.

Neto kreditë e sektorit jo bankar më 31 dhjetor 2013 ka arritur në 240,369 mijë EUR. Krahasuar me vitin paraprak kane shënuar rritje për 6,2 milion EUR, dhe plani është përmbushur për 93.0%. Kreditë e sektorit jo bankar janë rritur në të gjitha kreditë e lëshuara. Pjesëmarrja në treg e Bankës në kredi (JSB) në vitin 2013 është rritur përafërsisht në 14.9% (2012: 14.6%) të gjithsej sektorit bankar në Kosovë.


Ilustrimi 5: Total Neto kreditë (SJB) të NLB Prishtina



Provizionet për humbjet nga kreditë - Banka ka vazhduar të ketë një qasje konservative për krijimin e provizioneve për kredi. Provizionet për kredi në bilancin e gjendjes në vitin 2013 janë rritur për 4,041 mijë EUR dhe në fund të vitit arrijnë shumën 25,900 mijë EUR (2012: 21,859 mijë EUR).

Totali i depozitave të sektorit jo-bankar - ka mbetur shumë i qëndrueshëm nga viti në vit me 407,863 mijë EUR, dhe krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rritje për 40,646 mijë EUR (respektivisht 11.1%). Struktura e depozitave përbëhet nga 71 % për persona fizik dhe 29 % për persona juridik, përderisa depozitat e afatizuara përbëjnë 61.3% të gjithsej depozitave. Pjesëmarrja në tregun e depozitave është rreth 16.6%.

Ilustrimi 6: Total Depozitat e SJB të NLB Prishtina dhe Struktura



Huazimet në fund të vitit arritën në 5,454 mijë dhe në krahasim me vitin e kaluar janë zvogëluar gati rreth 3,320 mijë EUR (ose 37.8%). Te gjitha fondet e huazuara janë të pagueshme te institucioni financiar EFSE-KFW dhe të gjitha shumat duhet te paguhen deri më 30 Shtator 2016. Banka është mjaft likuide dhe nuk do të ketë nevojë për huamarrje nga banka amë, pasi që financiarisht është mjaft stabile.

Kapitali aksionar bazuar ne SNRF sipas datës 31 Dhjetor 2013 ishte 45,913 mijë EUR. Kapitali i Bankës është rritur në mënyrë organike gjatë viteve përmes kapitalizimit të fitimit të pashpërndarë. Fitimi për vitin 2013 sipas IFRS ishte 3,286 mijë EUR .

Ndërsa sipas standardeve Lokale (BQK), për vitin 2013 ishte 4,538 mijë EUR. Ndryshimet kryesore midis të dy kornizave të raportimit ishin në provisionet për humbjet nga kreditë, për shkak të metodologjive të ndryshme.

Banka ka vazhduar të jetë e kapitalizuar mirë, pavarësisht nga ndryshimet që kanë ndodhur në legjislacionin e rregullatorit, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) i NLB Prishtina ka vazhduar të mbetet i lartë në 16.5%, më shumë sesa kërkesat e përcaktuara nga BQK prej 12%.

8.2. Komentimi i bilancit të suksesit

Pavarësisht nga gjendja e vështirë e vazhdueshme e tregut dhe parashikimeve ekonomike, NLB Prishtina ka gjeneruar një fitim pas tatimit për vitin 2013 në shumën prej 3,286 mijë EUR.

Të hyrat neto nga interesi, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të të hyrave, përbëjnë shumën prej 14,021 mijë EUR për vitin 2013, dhe krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar rënie për 121 mijë EUR. Rënia është kryesisht për shkak të rritjes më të lartë të depozitave të klientëve dhe si rezultat i rritjes së shpenzimeve të interesit. Plani vjetor sa i përket të hyrave neto kamatore është përmbushur 92.9% kryesisht për shkak të ritmit më të ngadaltë të rritjes së kredive dhe qasjes më konservatore të kreditimit.


Të ardhurat nga interesi për vitin kanë arritur në 26.685 mijë EUR, një rritje prej 152 mijë EUR në krahasim me vitin e kaluar. Të ardhurat nga interesat e kredive kanë shënuar rritje prej 446 mijë EUR ose 2% dhe janë në të njëjtin trend si rritja e kredive neto, por kjo rritje është kompensuar nga rënia e të hyrave nga interesi nga bankat dhe letrat me vlerë në shumë prej 294 mijë EUR, kryesisht për shkak të rënies në normat e interesit nga 3.5% në nën 0.5 % në vitin 2013. Shumica e të ardhurave të bankave (98 % përafërsisht) është e gjeneruar nga kreditë në tregun e Kosovës dhe krizat që kanë ndodhur në Eurozonë nuk kanë pasur ndonjë efekt të rëndësishëm në rezultatet e Bankës.

Zërat kryesor nga Bilanci i Suksesit

000 EUR	Aktuale 1.1.-31.12.2012	Aktuale 1.1.-31.12.2013	Plani 1.1.-31.12.2013	Krahasimi me aktuale 1.1.-31.12.2013	
Të hyrat neto nga interesi	14,142	14,021	15,100	(121)	-1%
Të hyrat nga interesi	26,533	26,687	27,700	154	1%
Shpenzimet e interesit	(12,391)	(12,666)	(12,600)	(275)	2%
Të hyrat neto nga komisionet dhe provizionet	3,404	3,470	3,480	66	2%
Të hyrat nga komisionet dhe provizionet	4,374	4,436	4,520	64	1%
Shpenzimet nga komisionet dhe provizionet	(970)	(966)	(1,040)	2	0%
Të hyra të tjera	316	306	170	(10)	-3%
Të hyrat dhe shpenzimet operative	17,862	17,797	18,750	(65)	0%
Shpenzimet operative (gjithsej)	(11,088)	(10,016)	(11,200)	1,072	-10%
Shpenzimet e personelit	(5,202)	(5,086)	(5,160)	116	-2%
Shpenzimet e tjera operative dhe administrative	(4,795)	(3,858)	(4,440)	937	-20%
Zhvlërësi dhe amortizimi	(1,091)	(1,072)	(1,600)	19	-2%
Rezultatet financiare para provizioneve dhe tatimit	6,774	7,781	7,550	1,007	15%
Provizionet (gjithsej)	(1,708)	(4,082)	(2,220)	(2,374)	139%
Provizionet për kreditë	(1,794)	(3,872)	(1,860)	(2,078)	116%
Provizionet dhe rezerva e tjera	86	(210)	(360)	(296)	-344%
Total fitimi para tatimit	5,066	3,699	5,330	(1,367)	-27%
Shpenzimet e tatimit	(543)	(413)	(530)	130	-24%
Fitimi neto për vitin financiar	4,523	3,286	4,800	(1,237)	-27%

Shpenzimet e interesit arritën shumën prej 12,664 mijë EUR, që paraqet rritje prej 273 mijë EUR ose 2%, krahasuar me 3.5% rritje në depozita, kështu banka arriti të kontrollojë shpenzimet e interesit. Megjithatë ka vazhduar presioni në treg për të ulur marzhën e interesit, banka ka përmirësuar marzhën e saj neto të normës së interesit në vitin 2013 për 20 pikë bazike në 3.7% nga 3.5% sa ishte në vitin 2012.

Ilustrimi 7: Lëvizjet e zërave kryesorë në pasqyrën e të ardhurave 2011-2013




Neto të hyrat nga provizionet dhe kompensimet arritën në 3,470 mijë EUR në vitin 2013 (2012: 3,404 mijë EUR) ku kanë shënuar rritje për 66 mijë EUR ose për 2% krahasuar me vitin paraprak. Rritja më e madhe në **të hyrat nga provizionet dhe kompensimet** në vitin aktual ishte nga të hyrat prej kartelave kreditore të cilat kanë shënuar rritje për 200 mijë EUR, por rritja e tillë është neutralizuar nga aktivitetet e ngadalësuara dhe të hyrat më të ulta nga garancionet dhe letër kreditë prej 195 mijë EUR (më të ulta për 16%). Të hyrat nga transaksionet tjera kanë shënuar rritje të lehtë.

Në anën tjetër **shpenzimet nga provizionet dhe kompensimet** kanë mbetur pothuajse të pandryshuara në 966 mijë EUR (2012: EUR 970 mijë), me rënien më të madhe në shpenzimet nga garancionet prej 92 mijë EUR (ose 52%).

Gjithsej shpenzimet operative – banka ka vazhduar të fokusohet në disiplinën e buxhetimit, dhe kontrollit efektiv të shpenzimeve në përputhje me fitnes programin. Si rezultat, shpenzimet totale kanë shënuar rënie për 1,072 mijë EUR (ose 9.7%), në 10.016 mijë EUR (duke përfshirë edhe shpenzimet e amortizimit) në fund të vitit 2013.

Shpenzimet totale ishin gjithashtu më të ulta sesa ishte planifikuar në planin vjetor. Rënia kryesore është shënuar në shpenzimet e qirasë, më të ulta për 253 mijë EUR për shkak të transferimit në ndërtesën e re qendrore (centralizimi i zyrave) si dhe negocimit të kontratave të reja të qirave, shpenzimet e shërbimeve profesionale ishin më të ulta për 115 mijë EUR, të sigurimit dhe sigurisë ishin më të ulta për 77 mijë EUR, etj. Shpenzimet e stafit gjithashtu kanë shënuar rënie për 116 mijë EUR ose 2%. CIR ka shënuar rënie në 56.3% nga 62.1% në vitin 2012.

Ilustrimi 8: Shpenzimet operative për periudhën 2011-2013



Shënim: Detajet e politikave të kontabilitetit në bazë të cilave janë përgatitur pasqyrat financiare janë paraqitur në shpalosjet e pasqyrave financiare në këtë raport.

9. Aktivitetet sipas segmenteve afariste

9.1. Afarizmi me personat juridik

Klientët-persona juridik të NLB Prishtina janë në dispozicion për të kryer shërbime në 49 njësi të Bankës. Në vitin 2013 Banka ka vazhduar ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me personat juridik përmes ofrimit të shumëllojshmërisë së shërbimeve dhe menaxhimit të forcimit të mëtejshëm të pozicionit të Bankës në segmentin e korporatave .

Aktivitetet afariste me personat juridik paraqesin pjesën më të madhe të aktiviteteve të Bankës dhe përfaqësojnë një pjesë të madhe të rritjes/zgjerimit të Bankës. Këtu përfshihen kredi afatshkurtra për mjete qarkulluese , linja kreditore, mbiterheqje, kredi afatgjata për financimin e projekteve investive, kredive për ndërtimin e objekteve afariste, letër kreditë dhe garancionet, aktivitetet depozituese, shërbimet e transaksioneve të pagesave të brendshme dhe ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2013 , Banka u ka shërbyer më shumë se 15 mijë klientëve persona juridik dhe që bëjnë pjesë në industri të ndryshme, duke përfshirë kompanitë ndërkombëtare dhe institucionet financiare . Duke kombinuar ekspertizën e brendshme të tregut me njohuritë e Grupit NLB për tregun ndërkombëtar, Banka tashmë ka forcuar reputacionin e konceptit të sofistikuar të aktiviteteve me personat juridik.

Fokusi kryesor dhe strategjia e Bankës në vitin 2013 ishte në stabilitetin, sigurinë , dhe likuiditetin me qëllim të ndërtimit të imazhit si një prej bankave më të mira në Kosovë, duke përgatitur baza të forta për rritje/zgjerim të mëtejshëm në vitet e ardhshme .

Banka sa i përket personave juridik është e fokusuar në ruajtjen e cilësisë së portfolios kreditore, duke arritur rritjen e portfolios përmes vëmendjes së shtuar.

Oferta për personat juridik është bërë duke e respektuar modelin e menaxhimit të integruar të marrëdhënieve me klientët, sidomos për klientët e Bankës që janë korporata të mëdha, si dhe duke përmbushur nevojat dhe kërkesat e klientëve.

Tabela 4: Të dhënat kryesore të aktiviteteve me personat juridik

000 EUR	2012	2013	Rritja në 2013
Shuma e kredive të personave juridik (neto)	155,860	163,440	5%
Shuma e depozitave të personave juridik	123,788	119,695	-3%
-Depozitat e afatizuara	73,613	56,447	-23%
-Depozitat avista	50,175	63,248	26%
Garancionet	39,585	32,686	-17%
Letërkreditë	1,204	767	-36%
Numri i klientëve	20,129	15,293	-24%
Numri i llogarive	22,276	16,762	-25%
Numri i kartelave (kartelat debitore)	9,222	6,191	-33%
Numri i E-banking	1,828	2,172	19%

Përkundër situatës jo stabile ekonomike në rajon dhe krizës së vazhdueshme në Eurozonë, NLB Prishtina ka arritur të rrisë portofolion kreditore të personave juridik vit pas viti. Banka ka lëshuar rreth 1,750 kredi të reja të personave juridik , deri në fund të vitit 2013 totali i portfolios kreditore për personat juridik është rritur për 7 milion EUR duke arritur në 163 milionë EUR (net).

Ilustrimi 9: Kreditë e korporatave dhe depozitat për periudhën 2011-2013



Në fushën e operacioneve depozituese, aktivitetet ishin të drejtuara në menaxhimin e shpenzimeve lidhur me depozitat nga personat juridik dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri tek rënia e vëllimit të depozitave. Krahasuar me vitin 2012, depozitat nga personat juridik kanë shënuar rënie prej -3.2 % në vitin 2013 duke e ulur shumën në 120 milionë EUR

Gjatë vitit 2013, janë modifikuar dhe avancuar shërbimin e-banking me mundësi shtesë, sidomos me mundësinë për të paguar detyrimet doganore, taksat , etj.

Gjatë vitit 2013, Banka ka plasuar pakon e NVM-ve ku janë përfshirë produkte dhe shërbime të ndryshme me kushte të veçanta.

Projekti për Zhvillimin e Bujqësisë ishte shumë i suksesshëm , si rezultat i kësaj vetëm gjatë vitit 2013 janë dyfishuar kreditë për bujqësi , ku janë ofruar kushtet më të mira të kredive për bujqësi në treg

Aktivitetet tjera të kryera nga Divizioni i korporatave ishin edhe:

- Implementimi i softuerit për menaxhimin e kolateralit;
- Harmonizimi i kriterëve dhe procedurave për miratimin e investimeve me Grupin NLB;
- Harmonizimi i kriterëve dhe procedurave për miratimin e kredive dhe arkëtimin e kredive jo-performuese (zbatimi i standardeve minimale) me Grupin NLB, etj.

9.2. Afarizmi me Retail

Aktivitetet kryesore në Retail kanë qenë të fokusuar në arritjen e standardeve të NLB për Retail, bazuar në përvojat dhe rekomandimet e NLB d.d. në lidhje me shërbimet dhe produktet për klientët individual, si dhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Pavarësisht nga kufizimet ekonomike të tregut, mund të konkludojmë se Divizioni i Retail i NLB Prishtina ka arritur objektivat kryesore të planifikuara për vitin 2013.

Optimizimi i rrjetit afarist

NLB Prishtina është e pranishme në tërë territorin e Kosovës , në 9 rajonet më të mëdha , në 49 lokacione dhe 60 bankomate të vendosura në të gjitha njësitë e Bankës dhe në vendet më të frekuentuara . Më shumë se gjysma e njësive të NLB Prishtina (rreth 61 %) janë rinovuar në përputhje me standardet e NLB d.d., përderisa të gjitha shërbimet bankare dhe produktet e ofruara janë të fokusuar në nevojat e klientëve për shërbime bankare të sigurt dhe moderne.

Për të vlerësuar cilësinë e vërtetë të shërbimeve të ofruara nga banka dhe gjithashtu për të përmirësuar shërbimet në raste të caktuara, në bashkëpunim me Bankën amë janë organizuar hulumtime nga kompani të pavarura për të vlerësuar kënaqësinë e klientëve në lidhje me shërbimet e ofruara nga Banka . Rezultatet e hulumtimit kanë qenë shumë inkurajues për Bankën. Pavarësisht nga përpjekjet e Bankës për të modernizuar kanalet e shpërndarjes (kartelat , e- click , etj.) rezultati nga hulumtimi tregon se dega ose kontakti i klientit me punëtorët e Bankës dhe këshillat e klientit nga stafi i Bankës , paraqesin kanalin më të rëndësishëm të komunikimit .



Tabela 5: Të dhënat kryesore të aktiviteteve bankare me personat fizik

000 EUR	2012	2013	Rritja në 2013
Shuma e kredive të personave fizik (neto)	78,278	76,929	-2%
Shuma e depozitave të personave fizik	243,429	288,140	18%
Llogaritë rrjedhëse/Avista	50,746	55,463	9%
Llogaritë e kursimit	19,063	37,567	97%
Llogaritë e depozitave të afatizuara	173,620	195,110	12%
Numri i klientëve	241,405	226,713	-6%
Numri i llogarive	255,132	240,982	-6%
Numri i kartelave (kartelat debitore)	53,744	57,007	6%
Numri i kartelave (kartelat kreditore)	1,745	2,009	15%
Numri i E-banking	4,250	5,001	18%

Ilustrimi 10: Kreditë (neto) dhe depozitat e personave fizik (Retail) për periudhën 2011-2013



Afarizmi me llogari

Gjatë vitit 2013 fokusi i Bankës ka qenë në menaxhimin më të mirë të llogarive aktive të klientëve me të ardhura të rregullta duke ofruar produkte dhe shërbime të caktuara bankare. Mesataret mujore të hapjeve të llogarive të reja rrjedhëse ishin rreth 3 mijë llogari. Mbyllja e llogarive jo aktive (rreth 20.000) ka ndikuar në rënie të lehtë të totalit të llogarive rrjedhëse për individët , në fund të vitit 2013 me rreth 6 % (nga 255,132 në 240,982).

Kartelat dhe E - click - Zhvillimi i kanaleve të shpërndarjes moderne mbetet një angazhim i vazhdueshëm i Bankës . Banka ofron një rang të produkteve të lidhur me Visa dhe Master Kartela, tërheqjen e parave të gatshme nga bankomatet e Grupit NLB për të gjithë klientët e Grupit NLB me tarifa më të mira, Master Kartela me këste, Visa Revolving kartela kreditore me grejs periudhë 45 ditë etj

Sipas standardeve të NLB , të gjithë klientët e Bankës kanë të drejtë të marrin kartela debitorë (Visa Electron ose Maestro) . Gjithashtu ekzistojnë produkte të dizajnuara të kartelave kreditore për klientët të cilët kanë aftësi të mirë paguese . Rreth 65.000 klientë persona fizik janë të pajisur me kartela debitorë dhe kreditore. Numri i klientëve të ri dhe numri i përdoruesve aktivë i e-banking (e - click) është në rritje në të dy segmentet, por kjo fushë ende ka nevojë për kohë në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi. Shtrirja e internetit në Kosovë është relativisht i lartë , prandaj potenciali për E- click është i konsiderueshëm në të ardhmen .



Aktivitetet kryesore në lidhje me kartelat dhe e- click gjatë vitit 2013 ishin si në vijim:

- Instalimi i PIN Guards dhe i pajisjeve anti - skimming në të gjithë 60 Bankomatet
- Zhvendosja e disa bankomateve në lokacione më të mira (në vazhdim)
- Aktivizimi i SMS shërbimit të njoftimit,
- Inicimi i përgatitjeve për krijimin e Qendrës Kontaktuese.
- Blerja e bankomati depozitues , NCR Serf Serv 34, etj.

Afarizmi me kredi për personat fizik - mbetet një nga aktivitetet kryesore të Bankës. Pavarësisht nga konkurrenca e fortë, është disbursuar një numër i madh i kredive për personat fizik, në mesataren mujore prej rreth 3.5 milion EUR në shumë dhe 1,200 kredi në numër. Edhe pse, portofolio kreditore e klientëve individual në 2013 është zvogëluar për 1.7%, apo për 1.3 milion EUR duke arritur totalin e kredive për individët në 77 milion EUR (neto). Numri dhe shuma më e madhe e kredive të miratuara janë për kreditë BLND të cilat përbëjnë rreth 60% të totalit të kredive. Përmirësimi i kualitetit të portofolios kreditore ka qenë një nga objektivat e vitit 2013, e cila është përbushur. Rreth 92% e totalit të portofolios kreditore të personave fizik mbetet në kategorinë A.

Afarizmi me depozitat - mbetet një nga aktivitetet themelore tradicionale të Bankës. Depozitat e individëve gjatë vitit 2013 janë rritur për 18.3% duke arritur në total vlerën prej 288 milion EUR, ose rritje prej 44.5 milion EUR në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu kualiteti i depozitave ka pasur një rritje të vazhdueshme. Rreth 80% e depozitave janë depozita të afatizuara.

Aktivitetet e marketingut, produktet dhe shërbimet e reja

Gjatë gjithë vitit, NLB Prishtina ka organizuar fushatë marketingu për të mbështetur shitjen dhe rritjen afariste jo vetëm për personat fizik, por edhe për NVM dhe personat juridik.

Aktivitetet kryesore të marketingut ishin:

- Organizimi dhe lansimi i promovimit për kredi NVM dhe kredi individuale.
- Pjesëmarrja në aktivitetet e ndryshme financiare, të tilla si Panairi i Financave i organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës,
- Sponsorizimet e organizimeve të ndryshme, si pjesë e përgjegjësi sociale.
- Aktivitetet lidhur me themelimin e Qendrës Kontaktuese
- Organizimi i seksioneve të ndryshme të trajnimeve me stafin e shitjes të profileve të ndryshme.

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Rregulloreve tjera të Bankës Qendrore si EIR - (norma efektive e interesit) etj.

Shërbimi personal banking - është një shërbim i veçantë që i ofrohet klientëve të veçantë dhe me shumë kërkesa. Zhvillimi i këtij shërbimi ka qenë prioritet i segmentit për persona fizik të Bankës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore për klientët e zgjedhur dhe prestigjioz. Oferta e projektuar për këtë kategori të klientëve ka bërë që numri i klientëve në këtë kategori të rritet dhe në vitin 2013 ishte rreth 2 mijë.

9.3. Thesari dhe pagesat

Menaxhimi i Aktivës dhe Pasivës

Depozitat e personave fizik kanë mbetur burim kryesor i financimit të Bankës, duke u rritur më shpejtë se kreditë në vitin 2013 dhe duke kontribuar në zvogëlimin e raportit kredi / depozita në krahasim me vitin 2012. Në mënyrë që të ulët kostoja e përgjithshme e financimit, Banka ka rishikuar Politikën e çmimeve të depozitave të klientëve.

Menaxhimi i likuiditetit

Gjatë vitit 2013 NLB Prishtina ka vazhduar mbajtjen e niveleve të mjaftueshme të likuiditetit, me limitime në investimet në mjedisin ende të tensionuar ndërkombëtar.

Banka ka menaxhuar me sukses likuiditetin dhe ka siguruar pajtueshmëri me të gjitha dispozitat ligjore sipas rregulloreve të Bankës Qendrore, Udhëzimeve të Grupit NLB, si dhe llogaritjeve paraprake për standardet globale të likuiditetit – raportet e Basel III. Teprica e likuiditetit të Bankës ishte investuar në bankat e klasit të parë dhe në instrumente të letrave me vlerë debitore pa risk.

Banka ka qenë shumë aktive në tregun lokal dhe është vlerësuar nga Banka Qendrore dhe Ministria e Financave si tregtuesi primar kryesor në blerjen e letrave me vlerë të Qeverisë në vitin 2013 në tregun e Kosovës.

Gjatë vitit 2013, në bazë të Udhëzimeve të Grupit NLB, Banka ka implementuar metoda të reja për matje, monitorim dhe menaxhim, dhe ka kryer parashikime të rregullta të likuiditetit dhe skenarë të stres testit bazuar në skenarë të ndryshëm të supozimeve realiste dhe negative.


Në periudhën 1.1. - 31.12.2013, përmbushja mesatare e rezervës minimale obligative të likuiditetit të Bankës arriti në 184.17% rezervë të dedikuar likuide.

Tregu i këmbimeve valutore

NLB Prishtina është e vetmja bankë në tregun e Kosovës që ofron shërbimet e këmbimit valutor në 9 (nëntë) valuta likuide – USD, CHF, GBP, NOK, SEK, AUD, CAD, HRK dhe DKK.

Në tregun ndërkombëtar valutor, gjatë vitit 2013 mbi 5,466 transaksione janë tregtuar për shumën prej 192 milion EUR që paraqet një rritje prej 31.75% krahasuar me vitin e kaluar (2012: 146 milionë EUR).

Çifti i valutave më së shumti të tregtuara në mënyrë aktive gjatë vitit 2013 EUR / CHF kanë shënuar rritje prej 92% në krahasim me vitin e kaluar, gjithashtu edhe çifti i valutave EUR / GBP dhe EUR / NOK kanë shënuar rritje të shpejtë të vëllimeve të tregtimit.



Sistemet e pagesave

Në vitin 2013 Kosova ka hapur një kapitull të ri të historisë bankare duke hyrë si shtet i ri në rrjetin SWIFT. Kështu që nga 07.12.2013 NLB Prishtina zbatuar kodin e ri SWIFT me kodin e Kosovës (XK), që ka përmirësuar më tej besueshmërinë dhe efikasitetin e pagesave ndërkombëtare .

Në mënyrë që të zvogëlojë kostot e pagesave të klientit, gjatë vitit 2013 NLB Prishtina ka aplikuar disa tarifa më të ulëta për pagesat brenda Grupit NLB.

Në fushën e transaksioneve të pagesave ndërkombëtare, në 2013 janë procesuar më shumë se 36 mijë pagesat, si dhe është regjistruar një qarkullim prej gjithsej 557 milion EUR.

Remitencat kanë qenë 41% në total vëllimin e pagesave hyrëse ndërkombëtare dhe 3% të shumës totale të pagesave hyrëse ndërkombëtare .

Në fushën e transaksioneve të pagesave vendore, në vitin 2013 janë procesuar më shumë se 1,375 pagesa, si dhe është regjistruar një qarkullim prej gjithsej 1.77 miliard EUR, ose 7.27 % më shumë se në vitin 2012 . Më poshtë janë paraqitur shumat e pagesave vendore dhe numri i pagesave ndërkombëtare.

Trade Finance

Gjatë vitit 2013, Banka ka mbështetur tregtinë lokale dhe ndërkombëtare të klientëve duke lëshuar të gjitha llojet e letër garancioneve, letër kredive, me letër përkrahje (letters of intent), llogari të mirëbesimit dhe çeqe. Shuma totale e garancioneve dhe letër kredive më 31 Dhjetor 2013 arriti në shumën prej 33.453 mijë EUR.

9.4. Teknologjia informative

Gjatë vitit 2013, në fushën e TI-së janë zbatuar një numër i projekteve të infrastrukturës dhe aplikacioneve për të siguruar mbështetjen e duhur të TI për iniciativat e proceseve afariste dhe zhvillimore.

Ngjarja më e rëndësishme në vitin 2013 për sa i përket Infrastrukturës së TI është migrimi i qendrës së të dhënave (Datacenter) në një lokacion të ri. Datacenter është projektuar për të siguruar sigurinë dhe shërbimet e nevojshme për nevojat e teknologjisë informative të Bankës duke ndjekur standardet më të mira të vendosura nga agjencitë rregullatore ndërkombëtare. Datacenter i ri ofron furnizim me energji elektrike rezervë (Rezervë të sistemeve UPS dhe Rezervë të gjeneratorëve Diesel), Sistem të ftohjes së avancuar, sistem për eliminimin e zjarrit, lidhje me fibra të brendshme dhe të jashtme rezervë, HVAC monitorim të mjedisit, kontroll të qasjes së sigurte fizike dhe video monitorim.

Për të siguruar rimëkëmbje efikase në rast të fatkeqësive, Divizioni i TI vazhdon të ndjekë një proces të vazhdueshëm të shqyrtimit të Planit të Vazhdimësisë Afariste dhe Procedurave të rimëkëmbjes/ rikthimit duke i shqyrtuar dokumentet dhe duke kryer teste tremujore sipas planeve të përcaktuara në fillim të vitit kalendarik.

NLB Prishtina vë një theks të madh transparencës dhe riskut ndërpalësh. Si rezultat, Banka ka zbatuar një zgjidhje të dedikuar të menaxhimit të kolateralit në mënyrë që të kontrollojë dhe të zbusë riskun kreditor. Zgjidhja ofron një regjistër të të gjitha llojeve të kolateraleve të përdorura për mbulimin e ekspozimit dhe alokimin e tyre në llogaritë e arkëtueshme. Për më tepër, aplikacioni mundëson raportim të detajuar dhe kontroll të të gjithë kolateralit të regjistruar në sistem, si dhe ndarjes sipas metodologjive të ndryshme dhe algoritmeve të shpërndarjes. Ai mundëson konfigurimin e shpejtë dhe të thjeshtë dhe shtimin e llojeve të reja të kolateraleve, shtim dhe azhurim të lehtë të kolateralit ekzistues, llogaritjen e vlerës së drejtë në burim, raporte analitike mbi mbulimin nga llogaritë e arkëtueshme në bazë të metodologjive të ndryshme, monitorimin e historisë së attributeve të zgjedhura të kolateralit dhe krijimin e raporteve kontrolluese për raste të ndryshme që i mundësojnë të punësuarit përgjegjës për të reaguar menjëherë në ndonjë ndryshim.

NLB Prishtina njeh rëndësinë e respektimit dhe pajtimit me të gjitha ligjet kundër shpëlarjes së parave dhe kundër financimit të terrorizmit. Të gjithë të punësuarit në NLB Prishtina janë të obliguar të zbatojnë proceset e përgjithshme kundër shpëlarjes së parave të përcaktuara në Politikën e PSHP të Bankës. NLB Prishtina vazhdimisht kontrollon adekuatshmërinë e Politikës së shpëlarjes së parave dhe pajtueshmërinë me Politikën dhe i përmirëson kontrollet e brendshme bazuar në rezultatet e këtyre kontrolleve. Në vitin 2013, banka ka implementuar softuerin Tonbeller AML Siron që është në përputhje me rregullat të ndërkombëtare për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit duke siguruar monitorimin e transaksioneve, menaxhimin e integruar të rasteve, krijimin automatik të raporteve për aktivitetet e dyshimta, vizualizimin e lidhjeve në mes të transaksioneve, klientëve, llogarive dhe lokacioneve, në mënyrë për të zbuluar sa më shpejtë skemat e shpëlarjes së parave.

Në vitin 2013, Banka ka filluar me implementimin e projektit të Qendrës Kontaktuese që synon një ndërveprim më të mirë me klientët përmes një lokacioni të centralizuar për pranimin e kërkesave, urdhëresave dhe ankesave. Qëllimi është për të krijuar një qendër të përgjithshme kontaktuese për ofrimin e informacioneve për produktet dhe shërbimet, për shërbimet bankare telefonike, mbështetjen e klientëve të e-banking, mbështetjen e klientëve në përgjithësi, afarizmin me kartela, shitjen proaktive të produkteve, transferimin e ofrimit të informacioneve në lidhje me Bankën tek personat përgjegjës, monitorimin e kontakteve dhe mbledhjen e të dhënave. Përmes Qendrës Kontaktuese do të bëhet edhe monitorimi i afarizmit me bankomate dhe aktivitetet e arkëtimit të borxheve.

10. Menaxhimi i Riskut

10.1. Risku kreditor, Risku i likuiditetit, Risku i normës së interesit, Risku operacional

Në drejtim të tregut të Kosovës dhe trendeve globale të industrisë financiare, Sektori i Riskut i NLB Prishtina ka një rol kyç në operacionet bankare duke mbështetur qasjen konservative të menaxhimit të risqeve. Aktivitetet e ngjashme të menaxhimit të riskut janë zgjeruar nga përfshirja e mëtejshme e Sektorit në procesin e vendimmarrjes strategjike, gjithashtu duke shtuar vlerën dhe vetëdijesimin mbi riskun në fusha të tilla si çmimi dhe zhvillimi i produktit. Kështu, roli kryesor i Sektorit të menaxhimit të riskut është reflektimi dhe zbatimi i metodave në lidhje me riskun sipas Grupit NLB, sipas specifikave të tregut vendor, me një objektiv të vetëm të ruajtjes dhe kontributit në menaxhimin e cilësisë efektive dhe efikase të aseteve.

Risku kreditor

Risku kreditor përfshin menaxhimin e vazhdueshëm të portofolios përmes monitorimit dhe analizave të performancës së portofolios dhe koncentrimit. Kështu, ky proces përfshin monitorimin dhe analizimin e investimeve individuale, performancën financiare të klientëve në mënyrë që të sigurojë nivelin e duhur të cilësisë së aseteve.

Në 12 muajt e fundit NLB Prishtina ka ruajtur trendin e rritjes me diversifikim të arsyeshëm të portofolios me kredi dhe avanse për bankat, sektorin jo-bankar dhe ekspozimet jashtë bilancore. Rritja e portofolios ka qenë e përcjellur nga rritja e profitabilitetit, si dhe me një rritje të cilësisë së aseteve. Rritja vjetore e investimeve në SJB ishte 2.7%. Në mënyrë të ngjashme investimet ndaj sektorit bankar janë rritur për 23%. Duke pasur parasysh vetëdijesimin e NLB Prishtina mbi riskun, avancet e saj ndaj bankave janë fokusuar kryesisht në bankat ndërkombëtare me vlerësim të lartë ndërkombëtar kreditor.

Pjesëmarrja e klasifikimit kreditor A dhe B në portofolion e përgjithshme është 93% më 31 Dhjetor 2013 (91% si më 31 Dhjetor 2012), për investime në sektorin jobankar, i cili tregon një trend të shëndoshë dhe të qëndrueshme për performancën dhe cilësinë e portofolios. Ndërsa, mbulesa me provizione për kategoritë e mbetura të portofolios (C,D dhe E) është 128% si më 31 Dhjetor 2013 (127% si më 31 Dhjetor 2012).

Risku i likuiditetit

NLB Prishtina ka aprovuar Politikën e Menaxhimit të riskut të likuiditetit, duke përcaktuar limitet, masat dhe monitorimin e menaxhimit të riskut të likuiditetit. Gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2013 Sektori i menaxhimit të riskut ka monitoruar dhe raportuar mbi likuiditetin strukturor dhe likuiditetin operacional, në bazë të limiteve të përcaktuara nga politika e menaxhimit të riskut të likuiditetit, duke përfshirë limitet rregullative të vendosura nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Kështu që gjatë vitit NLB Prishtina për shkak të pozicionit të saj të qëndrueshëm të likuiditetit ishte në gjendje të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha limitet e përcaktuara.

Risku valutor

Risku valutor përfaqëson probabilitetin e realizimit të humbjeve për zërat bilancor dhe jashtë-bilancor, si rezultat i ndryshimeve në normat valutore dhe/ose mos-harmonizimi në nivelin e aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtë bilancor në valutë të njëjtë. Shumica e transaksioneve në valutë të huaj të kryera nga NLB Prishtina janë në dollar amerikan, franga zvicerane dhe në paund britanikë. Duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e mundshme të këmbimeve të huaja valutore, Sektori i menaxhimit të Riskut përcjell pozicionet e hapura valutore në baza ditore. Një monitorim i afërt i pozicionit, i ka mundësuar NLB Prishtina një menaxhim efikas dhe efektiv të pozicioneve të hapura duke i përmbushur limitet e caktuara me Politikën e Menaxhimit të Riskut Valutor. Pozicioni bruto i hapur valutor i Bankës më 31 Dhjetor 2013 sipas politikave të Grupit NLB duhet të jetë brenda kornizës së maksimum 3% të ekuitetit në çfarëdo momenti të caktuar kohor, ndërsa sipas kërkesave të BQK-së, pozicioni valutor i hapur për secilën valutë duhet të mos jetë më shumë se 15% e kapitalit të klasit të parë.

Risku i Normës së interesit

Qëllimi i menaxhimit të riskut është ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit dhe kufizimin e humbjeve të mundshme, e cila është krijuar si rezultat i modifikimit të niveleve të normave të interesit në treg dhe efektin e këtyre ndryshimeve mbi rezultatet afarist e dhe vlerës së tregut të kapitalit të Bankës. Sektori i Menaxhimit të Riskut bën monitorimin mujor të ekspozimeve të Bankës ndaj normave të interesit, përmes monitorimit të limiteve, në mënyrë që të sigurojë pajtueshmëri të plotë me afatet e përcaktuara nga politikat e menaxhimit të riskut të normës së interesit.

Risku operacional

Qëllimi i menaxhimit të riskut është të menaxhojë ekspozimin ndaj riskut operacional dhe zvogëlojë humbjet potenciale që mund të ndodhin për shkak të sistemeve të papërshtatshme të brendshme, procesit të kontrollit, dobësive dhe dështimeve gjatë procesit të punës, aktiviteteve ilegale dhe ngjarjeve të jashtme të cilat mund të shkaktojnë humbje Bankës.

Prandaj, në mënyrë që të mundësohet një sistem i shëndoshë i menaxhimit të riskut, NLB Prishtina ka krijuar strukturat e duhura (komiteti për menaxhimin e riskut operacional) dhe ka caktuar përgjegjësitë në strukturën organizative të Bankës, në mënyrë që të sigurojë identifikimin efikas të riskut, regjistrimin, zbutjen dhe monitorimin e riskut operacional. Në të njëjtën kohë, ngjarjet e dëmshme që rrjedhin nga risku operacional monitorohen në mënyrë aktive në baza mujore dhe raportohen tek organet e brendshme të NLB Prishtina.


Më shumë detaje, rreth menaxhimit të riskut janë të detajuara në shënimet e pasqyrave financiare në këtë raport.

10.2. Menaxhimi i riskut të adekuatshmërisë së kapitalit

Gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2013 adekuatshmëria e kapitalit të NLB Prishtina ka pasur një trend stabil. Sidoqoftë, pavarësisht nga prezantimi i rregulloreve të reja, NLB Prishtina ka qëndruar mbi minimumin e limiteve të caktuara të adekuatshmërisë së kapitalit, duke mbajtur një nivel mbi 12%. Në ndërkohë, për shkak të qasjes konzervative drejt menaxhimit të adekuatshmërisë së kapitalit, NLB Prishtina ka vazhduar me politiken e kapitalizmit gjatë vitit 2012, duke mos iu ndarë dividendën aksionarëve, në pajtueshmëri me vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve.

Më 31 Dhjetor 2013, kapitali ishte në shumën prej 43,314 mijë EUR (Tier I dhe II). Totali i mjeteve të rrezikuara në fund të vitit ishte 262,798 mijë EUR, dhe adekuatshmëria e kapitalit si më 31 Dhjetor 2013 ishte 16.5%.

Ilustrimi 11: Koefficienti i adekuatshmërisë së Kapitalit (CAR):



11. Përgjegjësia Korporative

NLB Prishtina merret me aktivitete të cilat janë në përputhje me Politikën Sociale dhe të Ambientit të Bankës sonë dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për përgjegjësitë e përbashkëta sociale, dhe i zhvillon ato. Ne fuqimisht besojmë se duke qenë ekonomikisht të suksesshëm dhe konkurrues gjenerojmë vlera për të gjithë akteret tanë, duke përfshirë aksionarët e Bankës, klientët, të punësuarit, si dhe të gjithë shoqërinë. Ne vazhdojmë të aplikojnë standarde të larta mjedisore dhe sociale në afarizmin bankar për të mbështetur një të ardhme të qëndrueshme. Ne gjithashtu kuptojmë që kemi për detyrë ndaj akterëve tanë që të jemi partner i besueshëm me integritet të lartë, etikë dhe transparencë. Ne vlerësojmë dallimet e njerëzve tanë dhe i mbështesim ata përmes trajnimeve të ndryshme dhe i ofrojmë një mjedis tërheqës të punës dhe ngritje të vazhdueshme. Progresi dhe prosperiteti janë shtyrje gjatë inicimit dhe mbështetjes së projekteve arsimore sociale dhe kulturore që i ndihmojnë njerëzit për të përmbushur dhe për të arritur qëllimin e tyre.

11.1. Aktivitetet sociale

Zhvillimi dhe siguria e të punësuarve në punë

NLB Prishtina i kushton një vëmendje të madhe njerëzve, njohurive të tyre, kapaciteteve, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave, dhe merr të gjitha këto karakteristika në konsideratë gjatë procesit të punësimit në bankë. Për më tepër Banka aplikon parimin e trajtimit të drejtë dhe mundësitë e barabarta për të gjithë të punësuarit në bankë. Banka vazhdon të ketë strukturë të balancuar në mes të punësuarve femra dhe meshkuj. Në vitin 2013, Banka ka bërë përpjekje për të ngritur njohuritë e të punësuarve të saj përmes seminareve të ndryshme, trajnimeve, praktikave më të mira dhe përvojave nga bankat e Grupit NLB. Banka gjithashtu ka ofruar edhe ndihmë financiare brenda mundësive të saj për studim dhe zhvillim profesional brenda punës dhe jashtë punës, në Kosovë dhe jashtë vendit, me qëllim të mbajtjes së një standardi të lartë të shërbimeve të ofruara për të gjitha palët e interesuara.

Banka në vitin 2013 ka vazhduar kontratën e sigurimit shëndetësor për të punësuarit e saj dhe familjarët e ngushtë.

Marrëveshjet për mësim- punë praktike

Me qëllim të aftësimit profesional në praktikë, Banka ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Kolegjin Riinvest dhe Institutin për Banka dhe Financa për pranim të studentëve në mësim- punë praktike si dhe në mënyrë individuale në bazë të kërkesave të studentëve. Nga të gjitha institucionet, Banka është shpërblyer me mirënjohje për kontributin e dhënë.

Gjatë periudhës raportuese në Bankë kanë vijuar mësimin – punën praktike 166 student dhe njëkohësisht janë lëshuar po aq Certifikata.

Aktivitetet humanitare dhe solidariteti ndaj komunitetit

Të punësuarit e NLB Prishtina janë të përfshirë në mënyrë aktive në fushatat humanitare edhe jashtë obligimeve normale të punës së tyre dhe përmes iniciativës së tyre kontribuojnë në përgjegjësinë sociale përmes:

- Pjesëmarrjes në fushata për dhurimin e gjakut të organizuar nga NLB Prishtina;
- Mbledhjes së kontributeve vullnetare nga të punësuarit për personat me aftësi të kufizuara dhe të sëmurët;
- Mbledhjen e kapakëve të shisheve të plastikës për qëllime bamirëse, dhe
- Duke marrë pjesë në fushata tjera të ndryshme.

Gjaku është i pazëvendësueshëm dhe është gjëja më e vlefshme që mund të dhurojmë. Me moton “Dhuro gjakun, shpëton një jetë e mbron shëndetin tënd.”, në javën e dhurimit të gjakut në Kosovë më 19 dhe 20.6.2013 për herë të parë Banka ka inkurajuar të punësuarit për dhurimin e gjakut, ku një pjesë e tyre i janë përgjigjur pozitivisht ftesës. Banka do të vazhdojë të marrë pjesë në këtë fushatë edhe në vitet e ardhshme. Gjithashtu, ka sponsorizuar me mjete materiale fshatin e fëmijëve SOS Kinderdorf, për fëmijët në nevojë. Klientët e Bankës të cilët gjate afarizmit të tyre hasin në vështirësi lidhur me kthimin e kësteve Banka u ndihmon që nëpërmjet ri programimi të kredive të tyre e në bashkëpunim me klientin të tejkalojnë vështirësitë e tyre.

11.2. Aktivitetet në aspektin e ambientit

NLB Prishtina është e vetëdijshme për përgjegjësinë e saj ndaj ambientit dhe bën çdo përpjekje të mundshme për të siguruar funksionimin e saj në përputhje me standardet e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe Politikën e saj të brendshme sociale dhe të mjedisit.

Banka me aprovimin politikave dhe procedurave të kreditimit ka parandaluar financimin e projekteve të klientëve të cilat mund të rrezikojnë ndotjen e ambientit. Një kufizim i tillë, e të cilit Banka i përmbahet është edhe tek linjat kreditore me të cilat Banka ngarkohet nga institucionet financiare ndërkombëtare

Banka gjithashtu inkurajon klientët e saj për të marrë kredi të cilat janë të destinuara për kujdesin ndaj ambientit.

Klubi i shahut NLB Prishtina ka organizuar disa turnirë. Vlen të përmendet në këtë raport se Klubi i shahut NLB Prishtina mbështetur nga Federata e Shahut e Kosovës, në ambientet e Hotelit Sirius” në Prishtinë ka mbajtur Turne Përvjetori i Pavarësisë 2013, që i kushtohet 17 Shkurtit- 5 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (sistemin Berger), ku morën pjesë 115 shahistë nga mbarë Kosova dhe Shqipëria.

NLB Prishtina gjatë vitit 2013 ka sponsorizuar edhe klube të ndryshme si: Klubin futbollit Prishtina, Klubin e Shahut “Hyzyri Talla”, Turnirin e futbollit të vogël ‘Beach Soccer Kosova’, Mute Fondacion, koncertin e muzikës serioze (zyra çeke) ku studentët kishin mundësi të ndjekin falas orë të muzikës të ligjëruara nga artistë të njohur, Shkollën “Mileniumi i tretë” projekti “different Wonderful”



12. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

NLB Prishtina ka vazhduar të jetë e përkushtuar për të siguruar që të punësuarit e saj do të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e reja duke u ofruar atyre një shumëllojshmëri të mundësive për zhvillim përmes trajnimeve të brendshme, të jashtme, e-Learning, trajnimeve në punë, etj. Këto aktivitete kanë rezultuar në zhvillim të njohurive në fushën e kryerjes së shërbimeve më të mira bankare dhe produkteve më të mira për klientët.

NLB Prishtina në vitin 2013 kishte qëllimin e caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore. Kjo duke u nisur edhe nga parimi se menaxhimi i burimeve njerëzore është qasja strategjike dhe koherente për menaxhimin e asetit më të vlefshëm të një kompanie – njerëzit që punojnë në të, të cilët individualisht dhe të gjithë bashkë kontribuojnë për arritjen e objektivave afariste.

Trendët e zhvillimit të cilat po i karakterizojnë ditët e sotme, pa dyshim tregojnë se shoqëria do të mbështet në vlera të reja, në thelb të të cilave janë vlerat jo-materiale, përkatësisht dituria, informatat, idetë komunikimi dhe inteligjenca e resurseve njerëzore. Nga ky këndvështrim, Banka në vitin që lamë pas ka bërë përpjekje për rinovimin e njohurive të të punësuarve të saj nëpërmjet plotësimit të njohurive përmes seminareve me ushtrime nga përvoja (NLB d.d.), sesioneve të punës për tema të zgjedhura, trajnimeve brenda dhe jashtë Bankës dhe studimit të rasteve dhe ligjëratave të lidhur me tema të veçanta. E veçantë e vitit 2013 ishte se për herë të parë Banka në bashkëpunim me NLB d.d., këta të fundit me institucionin E – CHO System në Lubjanë, ka filluar aplikimin e mbajtjes së trajnimeve me tema të ndryshme përmes E –arsimit.

Gjithashtu, është punuar ngushtë në bashkëpunim me Sektorin e burimeve njerëzore të NLB d.d në përpilimin e planeve konkrete dhe lidhjen e kontratave me kompani të jashtme profesionale të lëmi të ndryshme (psikologji, menaxhim etj.) të cilat do të merren me të punësuarit e segmentuar në grupe të caktuara për pozita udhëheqëse.


Se Banka ishte e përkushtuar të krijoj kushte sa më të mira edhe infrastrukturore për të punësuarit e saj vlen të potencohet se në vitin e kaluar është bërë përpunimi i objektit të shkëlqyer infrastrukturor i Selisë Qendrore të Bankës, i cili ofron kushte sipas standardëve ndërkombëtare për të punësuarit e Bankës dhe klientët e saj.


Tabela 6 : Struktura e të punësuarve

Moshë	Numri		
	2011	2012	2013
Deri në 30 vjeç	164	142	117
nga 31 deri 40 vjeç	172	189	209
nga 41 deri 50 vjeç	82	83	83
nga 51 deri 60 vjeç	90	93	92
Mbi 60	20	22	24
GJITHSEJ	528	529	525

Shkollimi	Numri		
	2011	2012	2013
<i>Më e ultë se shkolla e mesme</i>	164	142	117
Shkolla e mesme	172	189	209
Shkollim i lartë	82	83	83
Universitare	90	93	92
Pasuniversitare	20	22	24
TOTALI	528	529	525

Ilustrimi 12: Numri i të punësuarve në Bankë 2011 - 2013.





Pasqyrat financiare

NLB PRISHTINA SH.A.

Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor, 2013

PËRMBAJTJA	FAQE
DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT	3
RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR	4-5
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	9 - 81

DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT

Për aksionarët dhe bordin e drejtorëve të NLB Prishtina Sh.a.

Bordi Udhëheqës konfirmon përgjegjësinë e tij për përgatitjen e pasqyrave financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2013, dhe për politikat që shoqërojnë kontabilitetin dhe shënimet e pasqyrave financiare.

Bordi Udhëheqës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Bankës më 31 dhjetor 2013 rezultatet financiare dhe rrjedhat e parasë për vitin e përfunduar.

Bordi Udhëheqës gjithashtu konfirmon se politikat e duhura kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente, dhe se vlerësimet e kontabilitetit janë përgatitur në përputhje me parimet e kujdesit dhe menaxhimit të mirë. Bordi udhëheqës më tej konfirmon se pasqyrat financiare të Bankës, së bashku me shënimet shpjeguese, janë përgatitur në përputhje me parimin e vazhdueshmërisë së operimit të biznesit dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Bordi Udhëheqës është gjithashtu përgjegjës për praktikën e përshtatshme kontabël, për miratimin e masave të përshtatshme për ruajtjen e aseteve, dhe për parandalimin dhe identifikimin e mashtrimit dhe parregullsive të tjera ose akteve të paligjshme.

Prishtinë, Kosovë
20 Shkurt, 2014

Bordi Udhëheqës



Lavdim Koshutova

Anëtar i Bordit Udhëheqës



Bogdan Podlesnik

Anëtar i Bordit Udhëheqës



Albert Lumezi

Kryetar i Bordit Udhëheqës

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të NLB Prishtina Sh. a.

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të NLB Prishtina Sh. a të cilat përmbajnë pasqyrën e gjendjes financiare më 31 Dhjetor 2013, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrolleve të brendshme të nevojshme për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit; përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e vlerësimeve të arsyeshme kontabël në rrethanat përkatëse.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të përfituar siguri të arsyeshme për mungesën e gabimeve materiale në pasqyrat financiare.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për mbledhjen e evidencave të auditimit që mbështesin shumat dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak mashtrimesh apo gabimesh. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të përcaktuar procedurat e auditimit që i përshtaten rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të mbështetur opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat përcjellëse financiare japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të NLB Prishtina Sh.a më 31 Dhjetor 2013 si dhe të performancës së saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k

Prishtinë,

21 Shkurt 2014

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor, 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)

	Shënim	Dhjetor 31, 2013	Dhjetor 31, 2012
PASURITË			
Paraja e gatshme dhe gjendja me Bankën Qëndrore	4	97,163	70,405
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	60,034	48,720
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	240,368	234,138
Pasuritë financiare të disponueshme për shitje	8	54,104	58,383
Pasuritë tjera financiare	12	11	11
Pasuritë tjera	9	537	594
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	24	230	191
Pasuritë, prona dhe impiantet	10	10,756	10,281
Pasuritë afatgjata jo materiale	11	562	596
Tatimi i shtyrë	24	329	157
Gjithsej pasuritë		464,095	423,476
DETYRIMET			
Detyrimet ndaj bankave	12	866	209
Detyrimet ndaj klientëve	13	407,863	367,217
Detyrimet tjera financiare	14	3,218	3,557
Detyrimet tjera	15	781	745
Huamarrjet	16	5,454	8,774
Gjithsej detyrimet		418,182	380,502
EKUITETI			
Kapitali aksionar	17	20,498	20,498
Rezerva e ri-vlerësuar për letrat me vlerë	8	(106)	241
Fitimi i pashpërndarë		25,521	22,235
Gjithsej kapitali		45,913	42,974
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar		464,095	423,476

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Udhëheqës më 20 shkurt, 2014 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:



Z. Albert Lumezi
 Kryetar i bordit menaxhues



Z. Bilall Hoti
 Drejtor Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor, 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)

	Shënim	Dhjetor 31, 2013	Dhjetor 31, 2012
Të hyrat nga interesi	18	26,685	26,533
Shpenzimet e interesit	19	(12,664)	(12,391)
Të hyrat neto nga interesi		14,021	14,142
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	20	4,436	4,374
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	21	(966)	(970)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet		3,470	3,404
Neto fitimi nga këmbimet në valuta të huaja		382	369
Të hyrat/shpenzimet tjera operative		(76)	(53)
Shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë	6	(3,871)	(1,794)
Humbjet dhe provizionet tjera për zhvlerësim	7	(211)	86
Shpenzimet e personelit	22	(5,086)	(5,202)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	10,11	(1,071)	(1,091)
Shpenzimet administrative dhe të tjera operative	23	(3,859)	(4,795)
Fitimi para tatimit		3,699	5,066
Tatimi në fitim	24	(413)	(543)
Neto fitimi për vitin		3,286	4,523
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse /(humbja):			
Neto (humbjet)/fitimi nga ndryshimi i vlerës reale të AFS letrave me vlerë	25	(347)	247
Gjithsej të hyrat gjithpërfshirëse për vitin		2,939	4,770
Fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion (në EURO për aksion)	26	76.9	105.9

Shënimet shpjeguese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor, 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë EUR, përveç nëse ndryshe theksohet)

	Kapitali aksionar	Rivlerësimi i rezervës për AFS letrat me vlerë	Fitimi i mbajtur	Gjithsejt
Gjendja me datë 1 Janar, 2012	20,498	(6)	17,712	38,204
Neto fitimi për vitin	-	-	4,523	4,523
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse (humbjet)	-	247	-	247
Gjithsejt të hyrat gjithpërfshirëse/(humbja)	-	247	4,523	4,770
Gjendja me datë 31 Dhjetor, 2012	20,498	241	22,235	42,974
Neto fitimi për vitin	-	-	3,286	3,286
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse / (humbja)	-	(347)	-	(347)
Gjithsejt të hyrat gjithpërfshirëse/(humbja)	-	(347)	3,286	2,939
Gjendja me datë 31 Dhjetor, 2013	20,498	(106)	25,521	45,913

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB PRISHTINA SH.A.
PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË
Per vitin e perfunduar me 31 Dhjetor, 2013

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse është deklaruar ndryshe)

	Shënim	Dhjetor 31, 2013	Dhjetor 31, 2012
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi gjatë vitit para tatimit		3,699	5,066
Zhvlerësimi	10	868	914
Amortizimi	11	203	177
Shpenzimet e zhvlerësimit për humbjet nga kreditë	6	4,041	1,794
Shlyerja e pasurive afatgjata materiale		55	25
Të hyrat nga interesi		191	-
Shpenzimet e interesit		(26,685)	(26,533)
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative		12,664	12,391
		(4,964)	(6,166)
Rritja në rezervën e detyrueshme me BQK		(1,078)	(3,278)
Rritja në kreditë dhe paradhëniet për bankat		(11,314)	(3,636)
Rritja në kreditë dhe paradhëniet për klientët		(10,084)	(27,843)
Rritja në aktivën tjetër financiare		(1)	(11)
Rritja/ Zvogëlimi në aktivën tjetër		57	(303)
Rritja në detyrimet ndaj bankave		657	170
Rritja/ në detyrimet ndaj klientëve		40,323	36,711
Zvogëlim në detyrimet tjera financiare		(339)	(226)
Zvogëlim/Rritja në detyrimet e tjera		42	(574)
		13,299	(5,156)
Interesi i arkëtuar		26,477	26,440
Interesi i paguar		(12,352)	(11,925)
Tatimi i paguar në të ardhura	24	(578)	(777)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		26,846	8,582
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pasurive dhe pajisjeve		(1,398)	(4,185)
Blerjet e pasurive të paprekshme		(168)	(208)
Shitja/ (Blerje) e aktiveve financiare të disponueshme për shitje		4,299	(22,768)
Neto paraja e gatshme e përdorur në aktivitete investuese		2,733	(27,161)
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet financiare			
Pagesa e huazimeve		(3,309)	(3,853)
Hyrja e parave nga aktivitetet financiare		(3,309)	(3,853)
Rritja e parave të gatshme		26,270	(22,432)
Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e tyre më 1 Janar		99,876	122,308
Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 31 Dhjetor	4.1	126,146	99,876

NLB PRISHTINA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM****Per vitin e perfunduar me 31 Dhjetor, 2013**

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë EUR, përveç nëse është deklaruar ndryshe)

1. INFORMATAT TË PËRGJITHËSHME

NLB Prishtina Sh.a. është bankë komerciale (“Banka”) e regjistruar ne Regjistrinë e Kosovës nën Çertifikatën e Regjistrimit nr. 70053484 të datës 18 Dhjetor, 2007. Banka është krijuar nga bashkimi i dy bankave, Kasabank dhe Banka e re e Kosovës (gjatë vitit 2007 të dy bankat ishin nën kontroll të Nova Ljubljanska Banka d.d.), dhe ka fituar licencën për aktivitete bankare më 19 Dhjetor, 2007 nga Banka Qendrore e Kosovës (“BQK”).

Banka kontrollohet nga Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana me qendër në Slloveni (Banka amë), e cila posedon 81.21% të aksioneve sipas datës 31 Dhjetor 2013 (31 Dhjetor 2012: 81.21% të aksioneve). Aksionari i vetëm i Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana është Republika e Sllovenisë që posedon 100 % të aksioneve.

Qendra e Bankës gjendet në Rr. Kosta Novakovic P.N, Prishtinë, Kosovë. Banka vepron si bankë komerciale për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj me 9 degëve në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan, Besianë, Prizren, dhe 39 Nën-degë.

Banka më 31 Dhjetor, 2013 ka pasur 525 të punësuar (31 Dhjetor, 2012: 530).

Pasqyrat financiare për Bankën për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2013 janë aprovuar nga Bordi Udhëheqës më 20 Shkurt 2013.

Vërejtje: Këto pasqyra janë perkthim i verzionit anglisht të pasqyrave financiare të audituara, dhe në rast se ka ndonjë mosbarazim, jo harmonizim apo keqinterpretim në mes të dy llojeve, atëherë do të mbizoteron verzioni Anglisht i pasqyrave IFRS

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1. Deklarata e përputhshmërisë

Banka përgatit pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të bankës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe trupi paraprak. Krahas kësaj, janë zbatuar interpretimet e publikuara nga Komiteti për Interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (KISNRF).

Pasqyrat financiare SNRF të bankës përbëhen nga pasqyrat e gjendjes financiare, pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimit në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare.

2.2 Bazat e prëgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, përveç ri-vlerësimit të instrumenteve financiare. Politikat kryesore kontabël janë të shpalosura si më poshtë.

2.3 Valuta funksionale

Në pajtim me SNK 21, valuta funksionale e Bankës është EUR pasi është valuta e mjedisit primar ekonomik ku banka operon dhe reflekton substancën ekonomike të ngjarjeve.

2.4 Te hyrat kamatore dhe shpenzimet

Të ardhurat nga Interesi dhe shpenzimet regjistrohen në fitim dhe humbje për të gjitha Instrumentet që sjellin interes për bazë akruale duke përdorur metodën efektive treguese.

2.5 Tarifat dhe komisionet

Të hyrat nga tarifat e komisionet dhe shpenzimet që rrjedhin nga dhënia, respektivisht përdorimi i shërbimeve bankare janë regjistruar në fitim dhe humbje siç kanë ndodhur, në momentin kur janë përfshirë shërbimet, respektivisht përdoruar ato.

Tarifat e menaxhimit të kredive që ka gjasa të tërhiqen deri në fund janë shtyrë (së bashku me kostot direkt të lidhura) dhe regjistrohen si një korrigjim i normës efektive të Interesit të kredisë.

Të ardhurat nga pagesat dhe komisionet dhe shpenzimet përfshijnë gjithashtu pagesat nga letër garancionet dhe letërkreditë e lëshuara nga Banka në favor të klientëve, detyrimet e pagesave që rrjedhin nga bankat vendore dhe ndërkombëtare, dhe shërbimet tjera të ofruara nga Banka.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare

i. Klasifikimet

Instrumentet financiare në dispozicion për shitje janë ato asete që kanë për qëllim të mbahen për një periudhë të pacaktuar kohore, të cilat mund të shiten si plotësim i nevojave për likuiditet ose ndryshimeve në normat e interesit, kurseve të këmbimit ose çmimeve të kapitalit.

ii. Matjet

Pasuritë financiare maten fillimisht me vlerë të drejtë të tyre plus kosto transaksionit, nëse ka. Kreditë dhe kërkesat regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit, nëse ka. Pas njohjes fillestare këto maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën efektive të Interesit. Kosto e amortizimit llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të Interesit. Primet dhe zbritjet, duke përfshirë kostot e transaksionit fillestar, përfshihen në vlerën kontabël të Instrumentit të ndërlidhur dhe amortizimit në bazë metodës efektive të Interesit të Instrumentit, kur është e aplikueshme.

Metoda e Interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një aseti financiar dhe të ndarjes së të ardhurave të Interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e Interesit efektiv është norma që saktësisht zbritet arkëtimet e vlerësuar të ardhshme monetare (përfshirë të gjitha pagesat në pikat e paguara ose të pranuar që formojnë një pjesë integrale të normës së interesit efektiv, kostot e transaksionit dhe primet ose zbritjet e tjera) përgjatë jetës së pritur të asetit financiar, ose sipas rastit, një periudhe më të shkurtër.

iii. Instrumentet specifike

Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj janë artikuj që mund të konvertohen në para të gatshme në afat të shkurtër (me më pak se tre muaj maturim) dhe të cilat i nënshtrohen një risku të parëndësishëm të ndryshimit të vlerës. Shumat që lidhen me fondet që janë të një natyre të kufizuar janë të përjashtuara nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizua.

Reserva e detyrueshme për likuiditet

Në përputhje me rregullat e BQK, Banka duhet të plotësojë kërkesat minimale të likuiditetit mesatar. Kërkesat e likuiditetit llogariten në baza javore si 10 % e bazës së depozitave, të përcaktuar si mesatare e gjithsejt të detyrimeve të depozitave për sektorin jo-bankar në valutë euro dhe valuta të tjera, gjatë ditëve afariste për periudhën e mirëmbajtjes. Asetet me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e saj të likuiditetit janë depozitat në euro me BQK dhe 50% e ekuivalentit të EUR të shprehura në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së zbatueshme të depozitave. Për shkak se asetet likuide përkatëse nuk janë në dispozicion të Aktiviteteteve financiare të përditshme të Bankës, ato janë të përjashtuara nga paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj për qëllime të pasqyrës së qarkullimit të parasë.

2. PËRMbledhja e politikave të rëndësishme të kontabilitetit (VAZHDIM)

2.6 Instrumentet financiare (vazhdim)

Asetet financiare në dispozicion për shitje

Në njohjen fillestare, asetet financiare në dispozicion për shitje regjistrohen me vlerën e drejtë plus shpenzimet e transaksionit, nëse ka. Më pas ato mbahen me vlerën e drejtë. Vlerat e drejta të raportuara janë çmimet e vëzhgueshme të tregut ose vlerat e llogaritura me një teknikë vlerësimi të bazuar në tregun. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aseteve financiare të mbajtura për shitje regjistrohen si të ardhura tjera gjithëpërfshirëse. Në pozitën “rezerva e rivlerësimit të Instrumenteve financiare në dispozicion për shitje”, deri sa aset financiar të shlyhet nga regjistri apo të zhvlerësohet. Në këtë rast, fitimi ose humbja kumulative e regjistruar më parë në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse transferohet në Fitim ose humbje. Interesi i llogaritur duke përdorur metodën efektive të interesit dhe fitimet dhe humbjet në valutë të huaj në asetet që klasifikohen në dispozicion për shitje regjistrohen si fitim ose humbje.

Kreditë dhe paradhëniet

Kreditë dhe avanset klasifikohen si kredi dhe kërkesa. Kreditë dhe kërkesat maten me kosto të amortizuar. Kosto e amortizuar e një aset financiar ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aset financiar ose detyrimi financiar matet në regjistrimin fillestar minus pagesat kapitale, plus ose minus amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çfarëdo difference në mes të shumës fillestare dhe shumës së maturimit, dhe mes çfarëdo reduktimi (perms përdorimit të një llogari të pagesave) për zhvlerësim apo pamundësi të arkëtimit. Kreditë dhe avanset raportohen si neto e shtesave për zhvlerësim të kredive për të reflektuar shumat që priten të rikthehen.

iv. Çregjistrimi

Asetet financiare nxjerrën nga bilanci kur të drejtat kontraktuale të qarkullimit të parasë së aseteve financiare skadojnë apo asetet financiare transferohen dhe transferi kualifikohet si nxjerrje nga bilanci. Transaksioni trajtohet si transfer i asetit financiar, kur të gjitha risqet dhe beneficionet a njësisë transferohen. Kur banka nuk transferon dhe nuk mban të gjitha risqet beneficionet e pronësisë të asetit financiar, do të përcaktohen nëse banka do të mbajë kontrollën e aseteve financiare. Një detyrim financiar nxjerrët nga pasqyra e pozitës financiare dhe vetëm atëherë shlyhet. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon, respektivisht kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon.

v. Zhvlerësimi i aseteve financiare

